

1. HYRJE

Union Bank Sh.a. (“Banka”) eshte nje institucion financiar i regjistruar si banke tregtare me 9 janar 2006 bazuar ne Vendimin nr. 101, date 28 dhjetor 2005 te Bordit Mbiqyres te Bankes se Shqiperise (BSH). Aktiviteti i Bankes i nenshtrohet Ligjit nr. 8269 date 23 dhjetor 1997 “Per Banken e Shqiperise”, Ligjit nr. 9662 date 18 dhjetor 2006 “Per Bankat ne Republiken e Shqiperise” si dhe ne perputhje me te gjitha rregullat dhe rregulloret e aprovuara nga Keshilli Mbiqyres i Bankes se Shqiperise.

Banka eshte nje banke tregtare, e cila ofron sherbime bankare per individe dhe kompani ne Republiken e Shqiperise. Banka eshte regjistruar si shoqeri aksionare me numer regjistrimi 33563 date 26 maj 2005, date ne te cilen Banka filloi aktivitetin e saj tregtar. Banka mori licencen per aktivite bankare me 9 janar 2006.

Bazuar ne marreveshjen e shitblerjes te nenshkruar me shtator 2014, ne 22 dhjetor 2014, Banka bleu 100% te aksioneve te Landeslease Sh.a. (“Filiali”), dhe eshte aksionari i vetem i ketij institucioni financiar. Filiali eshte nje shoqeri lizingu shqiptar, e regjistruar si nje shoqeri aksionare, e cila u regjistrua dhe filloi te operonte ne 5 prill 2005.

Ne 1 nentor 2018, Banka nenshkroi nje marreveshje shitblerjeje me aksionaret e Bankes Nderkombetare Tregtare sha (“BNT”) per blerjen 100% te aksioneve te BNT, nje banke shqiptare, e regjistruar si shoqeri aksionare ne 1996 dhe e licencuar ne 20 shkurt 1997. Blerja u finalizua ne 20 mars 2019, pas marrjes se miratimit paraprak nga Banka e Shqiperise ne daten 18 mars 2019. Rregjistrimi i aksioneve te BNT ne Qendern Kombetare te Biznesit u krye me 27 mars 2019. Bashkimi ligjor dhe operacional u finalizua ne daten 1 gusht 2019 (“Data e Bashkimit”).

Keto pasqyra jane pasqyra financiare te vecanta te Bankes (“Mema”). Pergatitja e ketyre pasqyrave financiare te vecanta kerkohet nga legjislacioni tatimor vendas. Pervec ketyre pasqyrave, Banka pergatit pasqyra financiare te konsoliduara ne perputhje me kerkesat e SNRF 10. Ato pasqyra financiare te konsoliduara jane te Bankes dhe Filialit te saj (se bashku “Grupi”). Pasqyrat financiare te Filialit perfshihen ne pasqyrat financiare te konsoliduara duke filluar nga data ne te cilen fillon ushtrimi i kontrollit te Bankes mbi te e deri ne daten ne te cilen ky kontroll pushon se ekzistuar (shih shenimin 2.4).

Me 31 dhjetor 2019 Banka operonte me nje rrjet prej 33 degesh (31 dhjetor 2018: 30) ne te gjithe Shqiperine. Selia Qendrore e Bankes ndodhet ne Tirane, Shqiperi

Drejtuesit dhe administrimi i Bankes me 31 dhjetor 2019*Bordi Drejtues (Keshilli Mbiqyres)*

Edmond Leka	Kryetar
Niko Leka	Zv.Kryetar
Varuzhan Piranjani	Anetar
Melis Ekmen Tabojer	Anetar
Gazmend Kadriu	Anetar
Sokol Marishta	Anetar
Flutura Veipi	Anetar

Komiteti i Kontrollit

Varuzhan Piranjani	Kryetar
Sonila Bicaku	Anetar
Matilda Shehu	Anetar

Drejtimi Ekzekutiv

Gazmend Kadriu	Drejtor i Pergjithshem
Suela Bokshi	Drejtor i Divizionit te Operacioneve
Arten Zikaj	Drejtor i Divizionit te Finances
Enkeleda Hasho	Drejtor i Divizionit te Biznesit
Gent Drita	Zv/Drejtor i Divizionit te Kredise

Znj. Hasho zevendesoi Z. Petollari ne korrik te 2019 ne pozicionin e Drejtor i Divizionit te Biznesit.

Z. Drita, u promovua ne pozicionin e Zv/Drejtor i Divizionit te Kredise ne korrik te 2019, kur Znj. Hasho kaloi ne pozicionin e ri.

2. BAZA E PERGATITJES

2.1 Deklarata e perputhshmerise

Pasqyrat e vecanta financiare te Bankes jane pergatitur ne perputhje me Standardet Nderkombetare te Raportimit Financiar (“SNRF”) te nxjerra nga Bordi i Standardeve Nderkombetare te Kontabilitetit (“BSNK”).

2.2 Baza e pergatitjes

Pasqyrat financiare te vecanta te Bankes jane pergatitur mbi bazen e kostos historike me perjashtim te Pasurive te paluajtshme te mbajtura per investim, te cilat maten me vleren e drejte dhe inventareve te kolateraleve te marra ne pronesi te cilat maten me me te voglen midis kostos dhe vleres neto te realizueshme.

2.3 Monedha funksionale dhe ajo e prezantimit

Keto pasqyra financiare te vecanta te Bankes jane paraqitur ne Lek Shqiptar (Lek), e cila eshte monedha funksionale e Bankes. Gjithe informacioni i paraqitur ne Lek eshte rrumbullakosur ne mijeshen me te afert, pervecse kur eshte shprehur ndryshe.

2.4 Pasqyrat financiare te vecanta

Banka e regjistron investimin ne Filialin e saj (Shenimi 1 dhe Shenimi 11) me kosto. Banka njej dividendet e marre nga Filiali ne fitim ose humbje ne pasqyrat e saj financiare te vecanta kur e drejta per te marre dividendet eshte permbushur.

Banka ka aplikuar te gjitha SNRF-te ne fuqi ne paraqitjen e shenimeve sqaruese ne pasqyrat financiare te vecanta.

Banka, ne perputhje me SNRF-te pergatit, gjithashtu, dhe pasqyra financiare te konsoliduara per Banken dhe filialet e saj (“Grupi”). Filialet jane investime te kontrolluara nga Grupi. Grupi ‘kontrollon’ nje investim nese eshte i ekspozuar ndaj, apo ka te drejta mbi kthimin e ndryshueshem nga perfshirja ne investim dhe ka mundesine per te ndikuar mbi kete kthim nepermjet pushtetit te tij mbi investimin. Grupi rivlereson nese ka kontroll nese ka ndryshuar nje apo me shume nga elementet e kontrollit. Keto perfshijne rrethana ne te cilat te drejtat mbrojtese te patura (psh. ato qe rezultojne nga nje marredhenie kredidhenie) behen te rendesishme dhe bejne qe Grupi te kete pushtet mbi investimin. Pasqyrat financiare te konsoliduara mund te gjenden ne <https://unionbank.al/>. Perdoruesit e ketyre pasqyrave financiare te vecanta duhet t’i lexojne se bashku me pasqyrat financiare te konsoliduara te Grupit per vitin te mbyllur me 31 dhjetor 2019, ne menyre qe te sigurojne nje informacion te plote mbi pozicionin financiar, rezultatet operacionale dhe ndryshimeve ne pozicionin financiar te Grupit si nje te tere.

2.5 Perdorimi i vleresimeve dhe gjykimeve

Pergatitja e pasqyrave financiare te vecanta ne perputhje me SNRF-te kerkon qe Drejtimi te beje gjykime, vleresime dhe supozime te cilat ndikojne ne aplikimin e politikave kontabel dhe vlerave te raportuara te aktiveve, detyrimeve, te ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund te ndryshojne nga keto vleresime.

Vleresimet dhe supozimet baze rishikohen vazhdimisht. Rishikimet ndaj vleresimeve kontabel njihen ne periudhen ne te cilen ndodh rishikimi dhe ne periudhat e ardhshme qe afektohen/preken nga keto ndryshime. Drejtimi beson se vleresimet dhe supozimet baze jane te duhura dhe se, si rrjedhoje, pasqyrat financiare te vecanta paraqesin sakte pozicionin dhe rezultatit financiar. Ne vecanti, informacioni rreth elementeve kryesore te pasigurise se vleresimeve dhe gjykimeve kritike per aplikimin e politikave kontabel te Bankes, qe kane efekt te rendesishem ne shumat e njohura ne pasqyrat financiare te vecanta jane pershkruar ne shenimin 5.

3. NDRYSHIME NE POLITIKAT KONTABEL DHE SHENIMET SHOQERUESE

3.1 Standartet dhe interpretimet e reja dhe te ndryshuara

Ne keto pasqyra financiare, Banka ka aplikuar per here te pare SNRF 16 Qirate. Natyra dhe efektet e ndryshimit si rezultat i adoptimit te ketij standarti te ri kontabel jane pershkruar ne Shenimin 3.1.1 me poshte.

Standarte dhe interpretime te tjera aplikohen per here te pare ne 2019, por ato nuk kane ndonje ndikim ne pasqyrat financiare te vecanta te Bankes.

Standartet e reja dhe ato te ndryshuara si dhe interpretimet jane efektive per periudhat vjetore qe fillojne ne apo pas 1 janar 2019, pervecse kur shprehet ndryshe. Banka nuk ka filluar aplikimin perpara datave efektive te ndonje standarti, interpretimi apo rishikimi tjeter te dale, por ende te pa hyre ne fuqi.

3.1.1 SNRF 16 - Qirate

SNRF 16 zevendeson SNK 17 Qiradhenie, KIRFN 4 Percaktimi nese nje Marreveshje permban nje Qira, SIC-15 Qirate Operative-Nxitjet dhe KIS-27 Vleresimi i Substances se Transaksioneve qe Perfshijne Formen Ligjore te Qirase. SNRF 16 percakton parimet per njohjen, matjen, paraqitjen dhe dhenien e informacioneve shpjeguese te qirase dhe kerkon qe qiramarrësit te trajtojne te gjitha qirate sipas nje modeli te vetem ne bilanc.

Kontabiliteti i qiradhenesit sipas SNRF 16 eshte ne thelb i pandryshuar nga kontabilizimi aktual sipas SNK 17. Qiradhenesit do te vazhdojne t'i klasifikojne te gjitha qirate duke perdorur te njejtin parim klasifikimi si ne SNK 17 dhe te bejne dallimin midis dy llojeve te qirase: qirate operative dhe financiare. Per kete arsye, SNRF 16 nuk pati efekt per qirate ne rastin kur Banka eshte qiradhenese.

Banka adaptoi SNRF 16 duke perdorur qasjen retrospektive te modifikuar per te gjitha qirate e klasifikuara me pare si qira operative me daten e aplikimit te pare 1 janar 2019. Sipas kesaj qasjeje, standarti eshte aplikuar retrospektivisht me efektin kumulativ te aplikimit per here te pare te standartit njohur ne daten e aplikimit te pare. Banka zgjodhi lehtesine praktike te tranzicionit per mos rivleresuar nese nje kontrate permban apo jo nje qira ne 1 janar 2019. Ne vend te saj Banka, aplikoi standartin vetem per ato kontrata qe dhe me pare gjate zbatimit te SNK 17 dhe KIRFN 4 rezultonin si qira ne daten e aplikimit te pare.

Banka ka kontrata qiraje per te gjitha deget e saj, disa pajisje kompjuterike dhe disa makina. Perpara adaptimit te SNRF 16, Banka klasifikonte çdonjeren nga qirate e saj ne daten e njohjes si qira financiare apo operative. Politikat kontabel te perdoruara perpara 1 janar 2019, trajtohen ne Shenimin 4.22.4.

Me adaptimin e SNRF 16, Banka aplikoi qasjen e nje matjeje sipas nje njohje te vetme per te gjitha qirate me perjashtim te qirave afatshkurtra dhe qirave te aktiveve me vlere te ulet. Shenimi 4.22 jep politikat kontabel qe aplikohen duke filluar nga 1 janar 2019. Standarti parashikon kerkesa specifike per tranzicionin dhe lehtesira praktike, te cilat jane zbatuar dhe nga Banka.

- Qirate qe me pare jane trajtuar si qira operative

Banka njeh nje Aktiv me te drejte perdorimi dhe Detyrim te qirase per ato qira qe me pare jane klasifikuar si qira operative, me perjashtim te qirave afatshkurtra dhe qirave te aktiveve me vlere te ulet. Aktivi me te drejte perdorimi njihet per vleren e barabarte me detyrimin e qirase te rregulluar me vlerat e parapaguara apo te rrjedhura te qirase. Detyrimet e qirase jane njohur si vlera e aktualizuar e pagesave te pakryera te qirase, te skontuara me normen rritesse te huamartjes ne daten e zbatimit per here te pare.

Banka, gjithashtu, aplikoi praktikat lehtesuese ne dispozicion:

- Perdorimi i nje norme skontimi te vetme per nje portofol qirash me karakteristika te ngjashme ne menyre te arsyeshme
- Te mbeshtetet ne vleresimin e saj nese qirate jane detyruese menjehere para dates se zbatimit per here te pare
- Zbatimin e perjashtimeve per qirate afatshkurtra, per qirate per te cilat afati i qirase perfundon brenda 12 muajve nga data e zbatimit per here te pare
- Perjashtimi i kostove fillestare te drejtperdrejta nga matja e aktivitet me te drejte perdorimi ne daten e zbatimit per here te pare

3. NDRYSHIME NE POLITIKAT KONTABEL DHE SHENIMET SHOQERUESE (VAZHDIM)

3.1 Standartet dhe interpretimet e reja dhe te ndryshuara (vazhdim)

3.1.1 SNRF 16- Qirate (vazhdim)

- Perdorimi i supozimeve per te percaktuar afatin e qirase kur kontrata permban opsionin per te zgjatur afatin, apo per te perfunduar qirane

Bazuar ne sa me siper, ne 1 janar 2019:

- Aktive me te drejte perdorimi prej 802,229 mije Lek u njohen dhe u paraqiten ne nje ze me vete ne pasqyren e pozicionit financiar.
- Detyrime per qirate prej 802,229 mije Lek u njohen dhe u paraqiten ne nje ze me vete ne pasqyren e pozicionit financiar.
- Adaptimi i SNRF 16 nuk pati ndikim ne fitimin e akumuluar te Bankes.

Detyrimet per qirate ne 1 janar 2019 mund te rikonsilohet me angazhimet per qirate operationale ne 31 dhjetor 2018 si me poshte:

Angazhimet per qirate operationale te shpalosura ne 31 dhjetor 2018	110,208
Qirate per makina qe nuk jane perfshire ne angazhimet per qira operationale	26,426
Pagesa per qira qe nuk jane perfshire ne angazhimet per qira operationale	941,429
Angazhime per qira operationale ne 31 dhjetor 2018	1,078,063
<i>Perjashtime nga njohja:</i>	
Angazhime per qira te lidhura me qira afatshkurta	(10,141)
Angazhime per qira te lidhura me aktivet me vlere te ulet	(19)
Detyrime per qira te paskontuara	1,067,903
Skontimi duke perdorur normen rritesse te huamarrjes	(265,674)
Totali i detyrimeve per qira te njohura sipas SNRF 16 ne 1 janar 2019	802,229

Norma rritesse e huamarrjes mesatare vjetore e perdorur per te skontuar pagesat e ardhshme te qirase per zyra eshte 7.25% ne vit dhe per ATM-te dhe makinat eshte 8.5% ne vit. Norma bazohet ne normen mesatare qe disa kompani lizingu aplikojne ne aktive te ngjashme per profil rreziku dhe maturim te ngjashem.

4. POLITIKAT KRYESORE KONTABEL

Banka ka aplikuar ne menyre konsistente politikat e meposhtme kontabel per te gjitha periudhat e paraqitura ne keto pasqyra financiare, me perjashtim te standartit te ri SNRF 16 Qirate, i cili u aplikua duke filluar nga 1 janari 2019 duke perdorur metoden e qasjes retrospektive te modifikuar me efektin e adaptimit te standartit te njohur ne balancen e hapjes se fitimit te akumuluar ne 1 janar 2019.

4.1. Filiali dhe konsolidimi

Filialet jane entitete te konrolluara nga Banka. Banka pergatit pasqyrat financiare te vecanta dhe te konsoliduara ne perputhje me SNRF-te. Filiali mbahet me kosto ne pasqyrat financiare te vecanta. Pasqyrat financiare te konsoliduara jane te pergatitura ne menyre vullnetare nga Banka paveresisht se Banka permbush kriteret perjashtuese te SNRF-ve per pergatitjen e tyre, pasi pasqyrat financiare te Bankes konsolidohen nga aksionari fundor.

4.2. Transaksionet ne monedhe te huaj

Veprimet ne monedhe te huaj jane konvertuar ne monedhen funksionale me kursin e kembimit ne daten e transaksionit. Zerat monetare ne monedhe te huaj ne daten e raportimit jane konvertuar ne monedhen funksionale me kursin e kembimit ne ate date. Fitim/humbja nga monedhat e huaja per zerat monetare eshte diferenca midis koston se amortizuar ne monedhen funksionale ne fillim te vitit, e axhustuar per interesin efektiv dhe pagesat gjate vitit, dhe koston se amortizuar ne monedhe te huaj te konvertuar me kursin e kembimit ne fund te vitit.

Aktivitet dhe detyrimet jo-monetare ne monedhe te huaj qe maten me vlere te drejte, jane konvertuar ne monedhen funksionale me kursin e kembimit ne daten ne te cilen eshte percaktuar vlere e drejte. Zerat jo-monetare ne monedhe te huaj qe maten me kosto historike jane konvertuar duke perdorur kursin e kembimit ne daten e transaksionit.

4. POLITIKAT KRYESORE KONTABEL (VAZHDIM)

4.2 Transaksionet ne monedhe te huaj (vazhdim)

Diferencat qe vijne nga kurset e kembimit e prej konvertimeve jane njohur pergjithesisht ne pasqyren e vecante te te ardhurave permbledhese. Fitimet/ humbjet neto nga kembimi perfshijne te gjitha diferencat nga kurset e kembimit qe kane te bejne me transaksionet spot me date likuidimi dy dite pune pas dates se veprimit, megjithese keto transaksione njihen ne daten e likuidimit.

4.3. Interesat

Sipas SNRF 9, te ardhurat nga interesat regjistrohen duke perdorur metoden e normes efektive te interesit ("NEI") per te gjitha instrumentet financiare te matur me koston e amortizuar, instrumentet financiare te dizenuar me Vlere te Drejte ne fitim humbje ("FVPL"). Te ardhurat nga interesi per instrumentet financiare qe sipas SNRF 9 maten me Vlere te Drejte ne te ardhura te tjera permbledhese ("FVOCI"), gjithashtu regjistrohen duke perdorur metoden e normes efektive te interesit.

Norma efektive e interesit eshte norma me te cilen skantohen ekzaktesisht pagesat e vleresuara te ardhshme te mjeteve monetare ose arketimet pergjate jetes se pritshme te instrumentit financiar (ose kur eshte e pershtatshme per periudhen me te shkurter), duke arritur ne vleren kontabel neto te aktivitetit financiar.

NEI (dhe per kete dhe kosto e amortizuar e nje aktivi) perlllogaritet duke marre ne konsiderate ndonje skontim apo prim ne blerje, komisionet dhe kosto te tjera qe jane pjese integrale e NEI-t. Banka njeh te ardhurat nga interesat duke perdorur nje norme kthimi qe perfageson vleresimin me te mire te nje norme konstante kthimi gjate jetes se pritshme te huase. Per kete njeh efektin e normave te ndryshme te interesit te aplikuar ne faza te ndryshme, dhe karakteristika te tjera te ciklit te jetes se produktit (duke perfshire parapagimet, gjobat dhe komisionet).

Nese pritshmerite ne lidhje me flukset e parase per aktivin financiar rishikohen per arsye te tjera pervec te riskut te kredise, rregullimi regjistrohet si nje rregullim pozitiv apo negativ ne vleren e mbartur te aktivitetit ne pasqyren e vecante te pozicionit financiar kundrejt nje rritje apo ulje te te ardhurave/shpenzimeve nga/per interesi/a, e perlllogaritur duke perdorur metoden e normes efektive te interesit.

Per instrumentet financiare me norme te ndryshueshme, rivleresimi periodik i flukseve te parase qe reflekton levizjet ne normat e interesit te tregut gjithashtu ndikon normen efektive te interesit, por kur instrumentet jane njohur si fillim me vlere te barabarte me principalin, rivlersimi i pagesave te ardhshme te interesit nuk ndikon ne menyre te ndjeshme vleren e mbartur te aktivitetit ose pasivit.

Interesat dhe te ardhura te ngjashme

Te ardhurat neto nga interesat perbehen nga Te ardhurat nga interesat dhe Shpenzimet per interesa te perlllogaritura duke perdorur si metoden e normes efektive te interesit dhe metoda te tjera per to. Keto shpalosen te vecanta ne pasqyren e te ardhura dhe shpenzimeve si per te ardhurat, ashtu edhe shpenzimet per interesat per te dhene nje informacion simetrik dhe te krahasueshem. Ne shpenzimet/te ardhurat nga interesat e perlllogaritura duke perdorur metoden e normes efektive te interesit, Banka perfshin vetem ato interesa te instrumenteve financiare qe paraqiten ne kete shenim.

Banka perlllogarit te ardhurat nga interesat duke aplikuar normen efektive te interesit ne vleren bruto te aktiviteve financiare te cilat nuk jane te zhvleresuara. Kur nje aktiv financiar zhvleresohet (sic tregohet ne shenimin 37.1.2.1) dhe per kete arsye quhet si ne "Klasa 3", Banka i perlllogarit te ardhurat nga interesat duke aplikuar normen efektive te interesit mbi vleren neto te aktivitetit financiar. Nese aktivi financiar permiresohet (sic shpjegohet ne shenimin 37.1.2.1) dhe nuk eshte me i zhvleresuar, Banka e kthen menyren e perlllogaritjes se te ardhurave nga interesi mbi vlerat bruto te tij.

Per aktivitetet financiare te blera apo te krijuara te zhvleresuara ("POCI") (sic shpjegohet ne shenimin 4.12.1), Banka perlllogarit te ardhurat nga interesat duke perlllogaritur NEI-in te rregulluar dhe me pas duke e aplikuar ate norme mbi koston e amortizuar te aktivitetit.

NEI i rregulluar eshte norma e interesit e cila, ne njohjen fillestare, skanton flukset e ardhshme te parashikuara (duke perfshire dhe humbjen kreditore) ne vleren e amortizuar te aktivitetit POCI. Ne 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018, Banka nuk ka ne portofolin e saj ndonje aktiv POCI.

4. POLITIKAT KRYESORE KONTABEL (VAZHDIM)

4.4. Te ardhurat dhe shpenzimet nga komisionet

Banka fiton te ardhura nga komisionet nga nje shumellojshmeri sherbimesh te cilat ia ofron klienteve te saj. Te ardhurat dhe shpenzimet per komisione qe jane pjese e normave efektive te interesave te nje aktivi apo detyrimi financiar perfshihen ne matjen e normes efektive te interesit.

Komisionet dhe tarifat per te cilat Banka merr persiper detyrimin per te kryer nje sherbim, apo nje detyrim performane, ndaj klienteve, njihen si te ardhura nga sherbimet bankare bazuar ne SNRF15 Te ardhura nga kontratat me klientet. Kushtet e punes per sherbimet bankare (kontratat) zakonisht nuk perfshijne detyrime performimi te shumefishta te bashkuara ne nje vleresim dhe per pasoje nuk ka nje gjykim te rendesishem te alokimit te cmimit te transaksionit. Per me teper, sherbimet bankare te ofruara nga Banka kane nje kohezgjatje me pak se nje vit ose rinovohen ne baze vjetore(per shembull mirembajtaj e llogarive). Per pasoje, Banka ka perdorur pershtatshmerine praktike te standartit dhe nuk ka nevojte te paraqese informacion rreth shumes se agreguar te cmimit te lidhur me pjesen e pakenaqur te detyrimeve te performances.

Deyrimet e performances permbushen ose ne nje moment ne kohe, ku e ardhura nga komisioni njihet kur sherbimi eshte kryer dhe transferuar tek klienti, ose pergjate kohes gjate se ciles Banka permbush sherbimin gjate nje periudhe te dakorduar dhe klienti e merr sherbimin gjate gjithë kesaj kohe, dhe e ardhura njihet gjate gjithë periudhes ne fjale. Perkatesisht, te ardhurat nga komisionet njihen si me poshte:

- Te ardhurat nga komisionet te fituara nga sherbimet qe sigurohen gjate nje periudhe te caktuar kohe.

Komisionet e fituara per ofrimin e sherbimeve gjate nje kohe te caktuar njihen gjate kesaj kohe. Keto komisione perfshijne komisionet per mirembajtje llogarie, karta, sherbim E-banking, komisione per letrat e kredise ose garancive bankare dhene klienteve.

- Te ardhura nga komisionet te fituara nga sherbimet financiare dhe nga ekzekutimi i transaksioneve.

Ketu perfshihen komisione te fituara nga urdherat e pagesave apo transfertave te klienteve dhe sherbimeve te tjera bankare te ofruara klienteve. Keto komisione apo komponente te tyre qe jane te lidhur me nje zhvillim te caktua, njihen ne te ardhura kur kryhen sherbimet me te cilat jane te lidhura.

4.5. Humbje neto nga çregjistrimi i aktiveve financiare te matura me koston e amortizuar

Humbja neto nga çregjistrimi i aktiveve financiare te matura me koston e amortizuar perfshin humbjen (ose fitimin) njohur ne shitjen ose çregjistrimin e aktiveve financiare te matura me koston e amortizuar, perllogaritur si diference midis vleres kontabel (perfshire ketu dhe zhvleresimin) dhe arketimeve te marra.

4.6. Te ardhura nga dividendet

E ardhura nga dividenti njihet kur vendoset e drejta per te marre pagesen e tij.

4.7. Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin e vitit permban tatimin e vitit aktual dhe ate te shtyre. Tatimi mbi fitimin njihet ne pasqyren e veçante te fitim ose humbjeve te periudhes me perjashtim te rasteve qe lidhen me zera qe njihen direkt ne kapital ose ne te ardhura te tjera permbledhese.

4.7.1. Tatimi aktual

Tatimi aktual eshte shuma e pagueshme ose e arketueshme ne lidhje me fitimin ose humbjen e tatueshme per vitin, duke perdorur normat ne fuqi ne daten e raportimit, dhe ndonje axhustim per tatimin e pagueshem ne lidhje me vitet e meparshme.

4.7.2. Tatimi i shtyre

Tatimi i shtyre njihet mbi diferencat e perkohshme qe rezultojne midis bazes tatimore dhe vleres kontabel neto te aktiveve dhe detyrimeve ne pasqyrat financiare te veçanta. Tatimi i shtyre nuk njihet per diferencat e perkohshme qe lindin ne momentin e njohjes fillestare te aktiveve ose detyrimeve ne nje transaksion qe nuk eshte nje kombinim biznesi dhe qe nuk ndikon as fitimin/humbjen kontabel dhe as ate te tatueshem.

Matja e tatimit te shtyre pasqyron pasojat tatimore qe do te ndjekin menyren ne te cilen Banka pret, ne fund te periudhes raportuese, per te rimarre ose te shlyeje vleren kontabel te aktiveve dhe detyrimeve te saj.

4. POLITIKAT KRYESORE KONTABEL (VAZHDIM)

4.7. Tatimi mbi fitimin (vazhdim)

4.7.2. Tatimi i shtyre (vazhdim)

Tatimi i shtyre eshte matur me normat e tatimit qe pritet te aplikohen mbi diferencat e perkohshme ne periudhen kur detyrimi eshte likuiduar apo aktivi eshte realizuar, bazuar ne normat tatimore e ligjore ne fuqi ne daten e raportimit.

Aktivet dhe detyrimet tatimore te shtyra kompesojne njera-tjetren kur ka nje te drejte ligjore te zbatueshme per te kompesuar aktivet dhe detyrimet tatimore aktuale dhe kur ato lidhen me tatimet mbi te ardhurat te vena nga i njejti autoritet i taksave.

Taksat shtese qe rrjedhin nga shperndarja e dividendeve nga Banka njihen ne te njejten kohe kur njihet detyrimi per te paguar dividendet.

Nje aktiv tatimor i shtyre njihet per humbjet/kreditet e mbartura dhe diferencat e perkohshme te zbritshme, deri ne masen qe eshte i mundur qe te kemi te ardhura te tatueshme kundrejt te cilave ky aktiv tatimor pritet te perdoret. Aktivi tatimor i shtyre rishikohet ne çdo periudhe raportimi dhe zvogelohet deri ne masen qe nuk ka mundesi qe perfitimi i lidhur nga tatimi te mund te realizohet.

4.7.3. Ekspozimet tatimore

Ne percaktimin e shumes se tatimit aktual dhe te shtyre, Banka merr parasysh ndikimin e pozicioneve tatimore te pasigurta dhe nese taksa apo interesa shtese mund te jene te pagueshme. Ky vleresim mbeshtetet ne vleresimet dhe supozimet dhe mund te perfshije nje sere gjykimesh ne lidhje me ngjarjet e ardhshme. Informacionet e reja mund te behen te disponueshme dhe te bejne qe Banka te ndryshoje vendimin e saj ne lidhje me pershtatshmerine e detyrimeve tatimore ekzistuese; keto ndryshime ne detyrimet tatimore do te ndikojne shpenzimet tatimore ne periudhen ne te cilen eshte bere nje percaktim i tille.

4.8. Instrumentet financiare – Njohja fillestare

4.8.1. Data e njohjes

Aktivet dhe detyrimet financiare, me perjashtim te kredive e paradhenieve dhene klienteve dhe detyrimeve ndaj klienteve, fillimisht njihen ne daten e tregtimit qe eshte data ne te cilen Banka behet pale ne dispozitat kontraktuale te instrumentit. Kjo perfshin menyren standarte te tregtimit: blerje ose shitje e aktiveve financiare qe kerkojne dorezimin e aktiveve brenda nje afati kohor, pergjithesisht te percaktuar me rregullore apo konvente ne treg. Kredite dhe paradheniet dhene klienteve njihen kur fondet jane transferuar ne llogarite e klienteve. Banka njeh detyrimet ndaj klienteve kur fondet jane transferuar ne Banke.

4.8.2. Matja fillestare e instrumenteve financiare

Klasifikimi i instrumenteve financiare ne njohjen fillestare varet nga termat e tyre kontraktuale dhe modeli i biznesit per te menaxhuar keto instrumente, sic pershkruhet ne Shenimin 4.9.1.1. Instrumentet financiare fillimisht maten me vleren e drejte, me perjashtim te rasteve te aktiveve dhe detyrimeve financiare te regjistruar si aktive qe maten me vleren e drejte nepermjet fitimit ose humbjes ("FVPL"), per cilat kostot e transaksionit shtohen apo zbriten nga kjo vlere. Llogarite e arketueshme maten me çmimin e transaksionit. Ne rastet kur vlere e drejte e nje instrumenti financiar ne njohjen e fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit, Banka regjistron fitimin ose humbjen e Dites se pare, sic pershkruhet me poshte.

4.8.3. Fitimi ose humbja e Dites se pare

Ne rastet kur vlere e drejte e nje instrumenti ndryshon nga vlere e drejte ne njohjen fillestare dhe vlere e drejte bazohet ne teknika vleresimi qe perdorin vetem inputet e vezhgueshme ne transaksionet e tregut, Banka njeh diferencen midis çmimit te transaksionit dhe vleres se drejte ne te ardhurat neto te tregtimit. Ne ato raste kur vlere e drejte bazohet ne modele per te cilat disa nga inputet nuk jane te vezhgueshme, diferenca midis çmimit te transaksionit dhe vleres se drejte shtyhet ne kohe dhe njihet vetem ne fitim ose humbje kur inputet behen te vezhgueshme ose kur instrumenti çregjistrohet.

4. POLITIKAT KRYESORE KONTABEL (VAZHDIM)

4.8. Instrumentet financiare - Njohja fillestare (vazhdim)

4.8.4. Kategorite te aktiveve dhe detyrimeve financiare

Banka klasifikon te gjitha aktivet e saj financiare ne baze te modelit te biznesit per menaxhimin e aktiveve dhe si dhe kushteve kontraktuale te aktiveve, te matura me koston e amortizuar (shih Shenimet 4.19, 4.20 dhe 4.21).

Nje aktiv financiar matet me koston e amortizuar nese ploteson te dyja kushtet e meposhtme dhe nuk eshte dizenuar si FVPL.

- Aktiv mbahet brenda nje modeli biznesi, qellimi i te cilit eshte mbajtja e aktiveve per te mbledhur flukse monetare kontraktuale; dhe
- Kushtet kontraktuale te aktivitetit financiar japin ne datat e specifikuar flukse monetare te cilat perbehen vetem nga pagesa e principalit dhe interesit per shumen e papaguar te tij.

Banka mund te caktoj instrumente financiare ne FVPL, dhe per keto eliminon ose ul ndjeshem mosperputhjet e matjes ose te njohjes.

Banka klasifikon detyrimet e saj financiare, pervec angazhimeve te huase dhe garancive financiare, si te matura me koston e amortizuar te shpjeguar ne shenimet 4.11.2.2.

4.9. Aktivet dhe detyrimet financiare

4.9.1. Depozita dhe llogari me bankat, Hua dhe paradhenie per klientet, Letra me vlere te investimit

Banka mat Depozita dhe llogari me bankat, Hua dhe paradhenie per klientet dhe Letrat me vlere te investimit me koston e amortizuar vetem nese te dyja kushtet e meposhtme jane permbushur:

- Aktiv mbahet brenda nje modeli biznesi, qellimi i te cilit eshte mbajtja e aktiveve per te mbledhur flukse monetare kontraktuale; dhe
- Kushtet kontraktuale te aktivitetit financiar japin ne datat e specifikuar flukse monetare te cilat perbehen vetem nga pagesa e principalit dhe interesit per shumen e papaguar te tij (SPPI).

Detajet e ketyre kushteve jepen me poshte.

4.9.1.1. Percaktimi i modelit te biznesit

Banka percakton modelin e saj te biznesit ne nivelin qe reflekton me mire menyren se si menaxhon grupet e aktiveve financiare per te arritur objektivin e saj te biznesit.

Modeli i biznesit i Bankes nuk vleresohet bazuar ne instrumente individuale, por ne portofole te grupuara dhe bazohet ne faktore te vezhgueshem si:

- Menyra e vleresimit dhe raportimit te performances e modelit te biznesit dhe aktiveve financiare te mbajtura brenda atij modeli biznesi tek personeli drejtues te njesise ekonomike,
- Rreziket qe ndikojne ne ecurine e modelit te biznesit (dhe asetete financiare te mbajtura ne ate model biznesi) dhe, ne vecanti, menyren se si menaxhohen ato rreziqe,
- Si kompensohen menaxheret e biznesit (per shembull, nese kompensimi i tyre bazohet ne vleren e drejte te aktiveve te menaxhuara apo ne flukset monetare kontraktuale te mbledhura).
- Shpeshesia e pritshme, vlera dhe koha e shitjeve jane gjithashtu aspekte te rendesishme te vleresimit te modelit te biznesit te Bankes

Vleresimi i modelit te biznesit bazohet ne skenare te pritshem, pa marre ne konsiderate skenaret e "rastit me te keq" ose "rastin e stresit". Nese flukset e mjeteve monetare pas njohjes fillestare realizohen ne nje menyre te ndryshme nga pritshmerite fillestare te Bankes, Banka nuk ndryshon klasifikimin e aktiveve te mbetura financiare te mbajtura ne ate model biznesi, por perfshin informacion te tille gjate vleresimit te aktiveve financiare te sapo origjinuara ose ato te blera ne vazhdim.

4. POLITIKAT KRYESORE KONTABEL (VAZHDIM)

4.9. Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

4.9.1 Depozita dhe llogari me bankat, Hua dhe paradhënie per klientet, Letra me vlere te investimit (vazhdim)

4.9.1.2. Testi SPPI

Si nje hap i dyte i procesit te klasifikimit, Banka vlereson kushtet kontraktuale te aktiveve financiare per te identifikuar nese ata permbushin testin SPPI. 'Principali' per qellim te ketij testi percaktohet si vlera e drejte e aktivitet financiar ne njohjen fillestare dhe mund te ndryshoje gjate jetes se aktivitet financiar (per shembull, nese ka shlyerje te principalit ose amortizimin e primit / skontos).

Elementet me te rendesishem te interesit ne kuader te marreveshjes se huadhenies jane zakonisht konsiderata per vleren kohore te parase dhe rrezikut te kredise. Per te bere vleresimin SPPI, Banka zbaton gjykimin dhe shqyrton faktoret relevante si monedha ne te cilen eshte shprehur aktivi financiar dhe periudha per te cilen eshte percaktuar norma e interesit.

Ne te kundert, kushtet kontraktuale qe paraqesin nje ekspozim me pak se minimumi ndaj rreziqeve ose paqendrueshmeri ne flukset monetare kontraktuale qe nuk kane lidhje me nje marreveshje baze te huadhenies, nuk krijojne flukse kontraktuale te mjeteve monetare te cilat jane vetem pagesa e principalit dhe interesit mbi tepricen e huase. Ne raste te tilla, aktivi financiar kerkohet te matet ne FVPL.

Detyrimet financiare, pervec angazhimeve te huase dhe garancive financiare, maten me koston e amortizuar, shih Shenimin 4.28.

4.10. Riklasifikimi i aktiveve dhe detyrimeve financiare

Nese modeli i biznesit sipas te cilit Banka mban aktivet e saj financiare ndryshon, aktivet financiare te prekura nga ky ndryshim riklasifikohen. Kerkesat e klasifikimit dhe matjes qe lidhen me kategorine e re zbatohen ne menyre prospektive qe nga dita e pare e periudhes se pare te raportimit pas ndryshimit ne modelin e biznesit qe rezulton ne riklasifikimin e aktiveve financiare te Bankes. Gjate vitit ushtrimor dhe periudhes se meparshme kontabel nuk ka pasur ndryshime ne modelin e biznesit sipas te cilit Banka mban aktivet e saj financiare dhe per kete arsye nuk jane bere riklasifikime.

Detyrimet financiare nuk riklasifikohen.

4.11. Çregjistrimi i aktiveve dhe detyrimeve financiare

4.11.1. Çregjistrime nga modifikimet thelbesore

Banka çregjistron nje aktiv financiar, te tille si nje hua per nje klient, kur termat dhe kushtet jane rinegocuar ne ate mase qe, ne thelb, behet nje hua e re, me diferencen e njohur si fitim ose humbje nga çregjistrimi, deri ne masen qe nje humbje nga zhvleresimi nuk eshte regjistruar ende. Huate e reja te njohura klasifikohen si Klasa 1 per qellimet e matjes ECL, pervec nese kredia e re, konsiderohet te jete POCL.

Gjate vleresimit nese do te çregjistrohet nje hua per nje klient, nder te tjera, Banka konsideron faktoret e meposhtem:

- Ndryshimi ne monedhen e huase
- Futja e nje tipari te instrumentit te kapitalit
- Ndryshimi ne kunderparti
- Nese modifikimi eshte i tille qe instrumenti nuk do te permbushe me kriterin e SPPI

Nese modifikimi nuk rezulton ne flukse te mjeteve monetare qe jane ne thelb te ndryshme, modifikimi nuk rezulton ne çregjistrimin. Bazuar ne ndryshimet ne flukset e mjeteve monetare te skontuara me NEI fillestare, Banka regjistron nje fitim ose humbje modifikimi, ne masen paregjistruar ne humbjes nga zhvleresimi.

4.11.2. Çregjistrime te tjera pervec se ato nga modifikimet thelbesore

4.11.2.1. Aktive financiare

Nje aktiv financiar (ose, kur eshte e mundur, nje pjese e nje aktivi financiar ose pjese e nje grupi te aktiveve financiare te ngjashme) çregjistrohet kur te drejtat per te marre flukse monetare nga aktivi financiar kane skaduar. Banka, gjithashtu çregjistron aktivin financiar nese ajo ka transferuar aktivin financiar dhe transferimi kualifikohet per çregjistrim.

4. POLITIKAT KRYESORE KONTABEL (VAZHDIM)

4.11. Çregjistrimi i aktiveve dhe detyrimeve financiare (vazhdim)

4.11.2. Çregjistrime te tjera pervec se ato nga modifikimet thelbesore (vazhdim)

4.11.2.1. Aktivet financiare (vazhdim)

Banka ka transferuar aktivin financiar nese dhe vetem nese:

- Banka ka transferuar te drejtat e saj kontraktuale per te marre flukse monetare nga aktivi financiar; ose
- Ajo ruan te drejtat per flukset e mjeteve monetare, por ka marre detyrimin per te paguar plotesisht flukset monetare te marra pa vonesa materiale per nje pale te trete nen nje marreveshje 'kalimtare'.

Marreveshjet kalimtare jane transaksione ku Banka ruan te drejtat kontraktuale per te marre flukset e mjeteve monetare te nje aktivi financiar ("aktivi origjinal"), por merr nje detyrim kontraktual per te paguar keto flukse monetare ne nje ose me shume njesi ekonomike ('perfituesit eventuale '), kur te gjitha tri kushtet e meposhtme jane plotesuar:

- Banka nuk ka asnje detyrim te paguaje shumat per perfituesit eventuale, pervec nese ka arketuar shuma ekuivalente nga aktivi origjinal, duke perjashtuar paradheniet afatshkurtra me te drejten per rimarrjen e plote te shumes se huase plus interesin e perllogaritur me normat e tregut
- Banka nuk mund te shese ose te vendose si kolateral aktivin fillestar pervecse si siguri per marresit eventuale
- Banka duhet te dorezoje çdo fluks parash qe mbledh ne emer te perfituesve eventuale pa vonese materiale.

Pervec kesaj, Banka nuk ka te drejte te riinvestoje flukse te tilla te parase, me perjashtim te investimeve ne mjete monetare ose ekuivalente te parase duke perfshire interesin e fituar, gjate periudhes midis dates se arketimit dhe dates se dergeses se kerkuar per perfituesit eventuale.

Nje transferim kualifikohet per çregjistrim vetem nese:

- Banka ka transferuar thelbesisht te gjitha rreziqet dhe perfitimet e aktivitet; ose
- Banka nuk ka transferuar as ruajtur thelbesisht te gjitha rreziqet dhe perfitimet e aktivitet, por ka transferuar kontrollin e aktivitet

Banka e konsideron kontrollin te transferuar nese dhe vetem nese transferuesi ka aftesine praktike per te shitur aktivin ne teresine e tij per nje pale te trete te palidhur dhe eshte ne gjendje ta ushtroje ate aftesi ne menyre te njeanshme dhe pa vendosur kufizime shtese per transferimin.

Nese Banka as nuk ka transferuar e as nuk ka mbajtur ne menyre te konsiderueshme te gjitha rreziqet dhe perfitimet dhe ka mbajtur kontrollin e aktivitet, aktivi vazhdon te njihet vetem ne masen e perfshirjes se vazhdueshme te Bankes, rast ne te cilin, Banka njeh edhe nje detyrim te lidhur me te. Aktivitet e transferuara dhe detyrimi i lidhur me te maten ne nje baze qe reflekton te drejtat dhe detyrimet qe Banka ka mbajtur. Perfshirja e vazhdueshme qe merr formen e nje garancie mbi aktivin e transferuar matet me vleren me te ulet midis vleres kontabel fillestare te aktivitet dhe shumen maksimale te konsiderates qe mund t'i kerkohej Bankes te paguaje.

Nese perfshirja e vazhdueshme merr formen e nje opsioni te shkruar ose te blere (ose te dyja) ne aktivin e transferuar, perfshirja e vazhdueshme matet ne vleren qe Banka do te kerkohej te paguaje gjate riblerjes.

4.11.2.2. Detyrimet financiare

Nje detyrimi financiar çregjistrohet kur detyrimi i lindur prej tij zbatohet, anulohet ose skadon. Kur nje detyrim financiar ekzistues zevendesohet nga nje tjetër nga i njejtë huadhenes ne kushte thelbesisht te ndryshme, ose kushtet e nje detyrimi ekzistues ndryshohen ne menyre substanciale, zevendesimi ose modifikim i tille trajtohet si nje çregjistrim i detyrimit fillestar dhe njohje e nje detyrimi te ri. Diferenca midis vleres kontabel te detyrimit financiar fillestar dhe vleres se paguar njihet ne fitim ose humbje.

4. POLITIKAT KRYESORE KONTABEL (VAZHDIM)

4.12. Zhvleresimi i aktiveve financiare

4.12.1. Veshtrim i pergjithshem i parimeve te ECL

Banka ka regjistruar nje fond zhvleresimi per humbjet e pritshme te kredise per te gjitha huate dhe aktivet e tjera financiare te borxhit qe nuk mbahen ne FVPL, se bashku me angazhimet e huase dhe kontratat e garancise financiare, ne kete pjese te gjitha te quajtura si 'instrumente financiare'. Instrumentet e kapitalit neto nuk jane subjekt i zhvleresimit sipas SNRF 9.

Fondi i zhvleresimit ECL bazohet ne humbjet e kredise qe pritet te lindin gjate jetes se aktivitet (humbja e pritshme e kredise per jete ose LTECL), pervec nese nuk ka pasur rritje te konsiderueshme te rrezikut te kredise qe nga krijimi, rast ne te cilin, fondi bazohet ne humbjen e pritur e kredise ne 12 muaj (12mECL) sic eshte shenuar ne Shenimin 4.12.2. Politikate e Bankes per te percaktuar nese ka pasur nje rritje te konsiderueshme ne rrezikun e kredise jane paraqitur ne Shenimin 37.1.2.2.

Me perjashtim te aktiveve financiare POCI (te cilat jane konsideruar me poshte), ECL-te kerkohet te maten nepermjet nje fondi per humbje ne nje shume te barabarte me:

- ECL 12-mujore, dmth ECL gjate gjithë jetes qe rezulton nga ato ngjarje deshtimi ne instrumentet financiare qe jane te mundshem brenda 12 muajve pas dates se raportimit; ose
- LTECL, dmth ECL gjate jetes qe rezulton nga te gjitha ngjarjet e mundshme te deshtimit gjate jetes se instrumentit financiar.

Banka mat fondin e humbjeve ne nje shume te barabarte me LTECL, pervec per sa vijon, per te cilen ato maten si ECL 12 mujore:

- letrat me vlere te investimit te cilat percaktohen te kene rrezik te ulet te kredise ne daten e raportimit; dhe
- instrumente te tjera financiare ne te cilet rreziku i kredise nuk eshte rritur ndjeshem qe nga njohja e tyre fillestare.

Si LTECL ashtu dhe 12mECL jane llogaritur ne baza individuale ose ne baze kolektive, ne varesi te natyres se portofolit te instrumenteve financiare. Politika e Bankes per grupimin e aktiveve financiare te matura ne baza kolektive eshte shpjeguar ne Shenimin 37.1.3.1.

Banka ka krijuar nje politike per te kryer nje vleresim, ne fund te çdo periudhe raportuese, nese rreziku i kredise i nje instrumenti financiar eshte rritur ndjeshem qe nga njohja fillestare, duke marre parasysh ndryshimin ne rrezikun e deshtimit qe ndodh gjate jetes se mbetur te instrumentit financiar. Kjo shpjegohet me tej ne Shenimin 37.1.2.3.

Bazuar ne procesin e mesiperem, Banka grumbullon kredite e saj ne Klasen 1, Klasen 2, Klasen 3 dhe POCI, sic pershkruhet me poshte:

- Klasa 1: Kur kredite njihen per here te pare, Banka njej nje zhvleresim ne baze te 12mECL. Kredite e Klases1 gjithashtu perfshijne kredi ku rreziku i kredise eshte permiresuar dhe kredia eshte riklasifikuar nga Klasa 2.
- Klasa 2: Kur nje kredi ka shfaqur nje rritje te konsiderueshme ne rrezikun e kredise qe nga krijimi, Banka regjistron nje fond per LTECL-te. Kredite e Klases 2 gjithashtu perfshijne kredi, ku rreziku i kredise eshte permiresuar dhe kredia eshte riklasifikuar nga Klasa 3.
- Klasa 3: Huate qe konsiderohen te zhvleresuara plotesisht (siç jane shenuar ne Shenimin 37.1.2.1). Banka regjistron nje fond per LTECL-te.
- POCI: Aktivitet e blere ose te origjinuara te zhvleresuara ("POCI") jane aktivitet financiare qe jane te zhvleresuara qe ne njohjen fillestare. Aktivitet POCI regjistrohen me vleren e drejte ne njohjen fillestare dhe te ardhurat nga interesi njihen me pas ne baze te nje NEI te rregulluar. ECL-te njihen ose rimerren vetem ne masen qe ka nje ndryshim pasues ne humbjet e pritshme te kredise.

Per aktivitet financiare per te cilat Banka nuk ka shpresa te arsyeshme per rikuperimin e te gjithë shumes se mbetur, ose nje pjese te saj, vlere kontabel bruto e aktivitet financiar zvogelohet. Ky konsiderohet nje çregjistrim (i pjesshem) i aktivitet financiar.

Banka ka klasifikuar te gjitha aktivitet financiare te zhvleresuara te perfituara nepermjet kombinimit te biznesit ne te njejtin klasifikim si me pare dhe jo si POCI, sa kohe qe Banka ka blere dhe me pas eshte bashkuar me nje biznes si nje i tere.

4. POLITIKAT KRYESORE KONTABEL (VAZHDIM)

4.12. Zhvleresimi i aktiveve financiare (vazhdim)

4.12.2. Perllogaritja e ECL-ve

Banka llogarit ECL-te ne baze te skenareve te ponderuar me probabilitet e ndodhjes per te matur mungesat e flukseve te prishem te arketimeve, te skontuara ne nje peraftrim me NEI. Nje mungese e arketimeve te pritshme eshte diferenca midis flukseve te mjeteve monetare kontraktuale te pritshme dhe atyre qe njesia ekonomike pret te arketoje.

Menyra e llogaritjeve ECL eshte pershkruar me poshte dhe elementet kryesore jane si vijon:

- PD – *Mundesia e deshtimit* (“PD”) eshte nje vleresim i mundesise se deshtimit gjate nje horizonti kohor te dhene. Nje deshtim mund te ndodhe vetem ne nje kohe te caktuar gjate periudhes se vleresimit, nese aktivi nuk eshte çregjistruar me pare dhe vazhdon te qendroje ne portofolin e Bankes. Koncepti i PD-se shpjegohet me tej ne Shenimin 37.1.3.1.1.
- EAD – *Ekspozimi ne Deshtim* (“EAD”) eshte nje vleresim per ekspozimin ne nje date te ardhshme deshtimi, duke marre ne konsiderate ndryshimet e pritshme ne ekspozim pas dates se raportimit, duke perfshire parapagimet e principalit dhe interesit, te skeduluara ne kontrate apo jo, terheqjet e pritshme ne angazhime per financim te dhena, dhe interesa te rrjedhur nga pagesat e pakryera. EAD shpjegohet me tej ne Shenimin 37.1.3.1.3.
- LGD – *Deshtimi ne humbje* (“LGD”) eshte nje vleresim i humbjes qe del ne rastin kur ndodh nje deshtim ne nje kohe te dhene. Ai bazohet ne diferencen midis flukseve kontraktuale te arketimeve dhe atyre qe huadhenesi pret te arketoje, duke perfshire dhe realizimet e atyre qe vijne nga ndonje kolateral i marre. Zakonisht shprehet ne perqindje te EAD-se. LGD shpjegohet me tej ne Shenimin 37.1.3.1.4.

Keto parametra rrjedhin nga modelet statistikore te zhvilluara brenda Bankes dhe te dhena te tjera historike. Ato jane rregulluar per te pasqyruar informacionin e per ndikimet te elementeve potenciale te ardhshem sic shpjegohet ne Shenimin 37.1.3.2. Humbjet nga zhvleresimi dhe rimarrjet jane llogaritur dhe tregohen vecmas nga humbjet e modifikimit ose fitimet qe llogariten si nje rregullim i vleres kontabel bruto te aktivitet financiar.

Mekanika e metodës ECL eshte permblodhur me poshte:

- Klasa 1: 12mECL llogaritet si pjese e LTECL-ve qe perfaqesojne ECL-te qe rezultojne nga ngjarjet e deshtimit te nje instrumenti financiar qe jane te mundshme brenda 12 muajve pas dates se raportimit. Banka llogarit fondin e 12mECL bazuar ne pritshmerine e nje mospagimi qe ndodh ne 12 muajt pas dates se raportimit. Keto probabilitete te deshtimit te pritur 12-mujor aplikohen mbi nje EAD te parashikuar dhe shumezohen me LGD-ne e pritshme.
- Klasa 2: Kur nje hua ka shfaqur nje rritje te konsiderueshme te rrezikut te kredise qe nga krijimi i saj, Banka regjistron nje fond per LTECL. Mekanika eshte e ngjashme me ato te shpjeguara me siper, por PD-te dhe LGD-te vleresohen gjate gjithë jetes se instrumentit. Mungesat e arketimeve te pritura te parave skontohen me NEI origjinale.
- Klasa 3: Per kredite qe konsiderohen si te zhvleresuara (sic percaktohet ne Shenimin 37.1.2.1), Banka njeh LTECL per keto kredi. Metoda eshte e ngjashme me ate per aktivet e Klases 2, me PD te vendosur ne 100%. Kjo llogaritje eshte bere per tre skenare (nje skenar baze, nje optimist dhe nje pesimist).
- POCI: Aktivet POCI jane aktive financiare qe jane te zhvleresuara qe ne njohjen fillestare. Banka njeh vetem ndryshimet kumulative ne LTECL-te qe nga njohja fillestare, skontuar nga NEI e rregulluar.
- Angazhimet e kredise dhe letrat e kreditit: Gjate vleresimit te ECL-ve per angazhimet e huazuara, Banka vlereson pjesen e pritshme te angazhimit te huase qe do te terhiqet gjate jetes se tij te pritshme. ECL pastaj bazohet ne vleren aktuale te mungesave te pritura ne flukset e mjeteve monetare nese kredia eshte terhequr. Mungesat e arketimeve te pritshme skontohen me NEI e pritshme te huase. Per kartat e kreditit dhe kredite rrotulluese qe perfshijne si nje hua dhe nje angazhim te paterhequr, ECL llogariten dhe paraqiten se bashku me huane. Per angazhimet e kredise dhe letrat e kreditit, ECL njihet brenda Provizioneve.

4. POLITIKAT KRYESORE KONTABEL (VAZHDIM)

4.12. Zhvleresimi i aktiveve financiare (vazhdim)

4.12.2. Perlllogaritja e ECL-ve (vazhdim)

- Kontratat e garancise financiare: Detyrimi i Bankes sipas seciles çdo garanci matet me vleren me te larte te shumes se njohur fillimisht, pakesuar me amortizimin kumulativ te njohur ne pasqyren e te ardhurave dhe provizioneve ECL. Per kete qellim, Banka vlereson ECL-te bazuar ne vleren aktuale te pagesave te pritshme per te rimbursuar mbajtesin per nje humbje kredie qe ajo shkakton. Mungesat e arketimeve skontohen me nje norme interesi te rregulluar nga rreziku qe lidhet me ekspozimin. ECL-te qe lidhen me kontratat e garancise financiare njihen brenda Provizioneve.

4.12.3. Informacion per ndodhi qe priten te ndodhin

Ne modelet e saj ECL, Banka mbeshtetet ne nje game te gjere te informatave te ardhshme, si inpute ekonomike, si:

- Rritja e Produktit te Brendshem Bruto (“PBB”)
- Normat e papunesise
- Inflacioni

Inputet dhe modelet e perdorura per llogaritjen e ECL-ve nuk mund te kapin gjithnje karakteristikat e tregut ne daten e pasqyrave financiare. Per te pasqyruar kete, rregullime cilesore behen here pas here si rregullime te perkohshme, kur dallimet e tilla jane dukshem materiale. Informata te hollesishme rreth ketyre inputeve dhe analizes se ndjeshmerise jepen ne Shenimin 37.1.3.1.2.

4.12.4. Paraqitja e fondit per zhvleresim ECL ne pasqyren e pozicionit financiar

Fondet e zhvleresimit per ECL jane paraqitur ne pasqyren e pozicionit financiar te Bankes si me poshte:

- Aktivitetet financiare te matura me koston e amortizuar: si zbritje nga vlera kontabel bruto e aktivitetit;
- Kontratat e angazhimeve te huase dhe kontratat e garancive financiare: pergjithesisht si nje provizion;
- Kur nje instrument financiar perfshin si nje komponent te terhequr dhe nje komponent te paterhequr angazhimi, dhe Banka nuk mund te identifikojë ECL-ne per komponentin e angazhimit te kredise vecas nga ato per pjesen e terhequr: Banka paraqet nje fond te kombinuar zhvleresimi per te dy komponentet. Shuma e kombinuar paraqitet si nje zbritje nga vlera kontabel bruto e komponentit te terhequr.

4.13. Permiresimet e kredise: vleresimi i kolateralit dhe garancite financiare

Per te zbutur riskun e kredise ne aktivet financiare, Banka kerkon perdorimin e kolateraleve, kurdo qe eshte e mundur. Kolaterali eshte i formave te ndryshme, si depozita, letra me vlere, garanci, pasuri e patundshme, te drejta dhe inventare.

Kolaterali, pervec atij te sekuestruar, nuk regjistrohet ne pasqyrat financiare te Bankes.

Flukset e pritshme nga permiresimet e kredise te cilat, ne baze te SNRF-ve, nuk kerkohen te njihen me vete dhe qe konsiderohen pjese e kushteve kontraktuale te nje instrumenti i cili eshte subjekt i zhvleresimit, perfshihen ne matjen e atij zhvleresimi. Ne keto kushte, vlera e drejte e kolateralit ndikon perlllogaritjen e ECL-ve. Kolaterali zakonisht vleresohet te pakten ne lindjen e kredise dhe ne varesi te llojit te tij, rivleresohet nje here ne vit ose nje here ne tre vjet. Megjithate, disa kolaterale, per shembull, depozitat apo letrat me vlere vleresohen ne baze ditore. Detajet e ndikimit te permiresimeve te kredise te Bankes, shpalosen ne Shenimin 37.1.5.

Per aq sa eshte e mundur, Banka perdor te dhenat e tregjeve aktive per te vleresuar aktivet financiare te mbajtura si kolateral. Aktivitetet e tjera te cilat nuk kane vlera tregu te matshme, vleresohen duke perdorur teknikat e vleresimit. Kolateralet jo-financiare, si pasurite e patundshme, vleresohen ne baze te te dhenave te siguruar nga pale te treat, si agjente imobiliare, ose bazuar ne indeksin e çmimeve te shtepive.

4.14. Kredite e ristrukturuara dhe te modifikuara

Banka ne disa raste ben modifikime ne kushtet fillestare te kredise si nje pergjigje ndaj veshtiresive financiare te kredimarresit, ne vend qe te sekuestroje kolateralet e kredise. Banka e konsideron nje kredi te ristrukturuar kur keto modifikime behen si rezultat i veshtiresive financiare aktuale apo te pritshme te kredimarresit dhe qe Banka ne te kundert nuk do te kishte rene dakord per to, nese kredimarresi do te kishte nje situatë te shendetshme financiare. Treguesit e veshtiresive financiare perfshijne shkelje te kufijve te treguesve financiare te dakorduar ne marreveshje, ose shqetesime te qenesishme te ngritura nga

4. POLITIKAT KRYESORE KONTABEL (VAZHDIM)

4.14. Kredite e ristrukturuara dhe te modifikuara (vazhdim)

Departamenti i Riskut te Kredise. Ristrukturimi mund te perfshije dhe riskedulime te pagesave te dakorduara si dhe dakordesine per kushte te reja te kredise. Pas rinegocimit te kushteve te reja, zhvleresimi matet duke perdorur normen fillestare NEI te perlllogaritur perpara modifikimit te kushteve. Politikat e Bankes per monitorimin e kredive te ristrukturuara ndihmojne ne rritjen e sigurise qe arketimet e ardhshme te jene te mundshme te kryhen.

Vendimet per çregjistrimin dhe riklasifikimin midis Klases 2 dhe Klases 3 merren ne baza individuale. Nese keto procedura identifikojne nje humbje ne lidhje me nje kredi, ajo shpaloset dhe menaxhohet si nje kredi e ristruktuar ne Klasen 3 deri ne mbledhjen e plote te saj apo ne fshirjen e saj nga librat kontabel.

Kur nje kredi eshte ristruktuar ose modifikuar por nuk eshte çregjistuar, Banka gjithashtu rivlereson nese ka patur nje rritje te qenesishme te riskut te saj te kredise, sic tregohet ne Shenimin 37.1.2.2. Banka gjithashtu konsideron nese aktivi duhet te klasifikohet ne Klasen 3. Nje here qe nje aktiv eshte klasifikuar si ristrukturim, ai do te qendroje i tille per te pakten nje periudhe prove prej 24 muajsh.

Detajet per aktivet e ristrukturuara shpalosen ne Shenimin 37.1.5.

Nese modifikimet jane thelbesore, kredia çregjistrohet sic tregohet ne Shenimin 4.11.

4.15. Kompesimi

Aktivitet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe shuma neto paraqitet ne pasqyren e veçante te pozicionit financiar, atehere dhe vetem atehere kur Banka ka te drejten ligjore per te kompesuar shumat dhe ajo synon ose te shlyeje ato ne nje baze neto, ose te realizoje aktivin dhe te shlyeje detyrimin njekohesisht.

Te ardhurat dhe shpenzimet paraqiten ne baze neto vetem atehere kur lejohet sipas SNRF, ose per fitimet dhe humbjet e krijuara nga nje grup transakcionesh te ngjashme si per shembull ato te aktivitetit tregtar te Bankes.

4.16. Fshirja

Aktivitet financiare fshihen pjeserisht ose teresisht vetem kur Banka ka ndaluar ndjekjen e rikuperimit. Nese shuma qe duhet te fshihet eshte me e madhe se fondi i zhvleresimit te akumuluar, diferenca fillimisht trajtohet si shtese e ketij fondi i cili me pas zerohet ndaj vleres kontabel bruto.

4.17. Matja me koston e amortizuar

Kosto e amortizuar e nje aktivi ose detyrimi financiar eshte vlere me te cilin aktivi ose detyrimi financiar matet ne njohjen fillestare, minus shlyerjet e principalit, plus ose minus amortizimin e akumuluar duke perdorur metodën e interesit efektiv per çdo diference ndermjet vleres fillestare te njohur dhe vleres ne maturim, minus çdo zbritje per efekt zhvleresimi.

4.18. Matja e vleres se drejte

‘Vlera e drejte’ eshte çmimi me te cilin aktivi mund te shitet, ose nje detyrim te transferohet, ne nje transakcion te zakonshem mes pjesemarresve ne treg ne daten e matjes, ne nje treg primar ose ne mungese te tij, ne tregun me te favorshem ne te cilin Banka ka akses ne ate date.

Per te treguar se si jane nxjerre vlerat e drejta, instrumentet financiare jane riklasifikuar bazuar ne nje hierarki te teknikave te vleresimit, siç permbledhet me poshte:

- Niveli 1: Ato ku inputet e perdorura ne vleresim jane çmimet e kuotuar te parregulluara ne tregjet aktive per nje instrument identik ne te cilat Banka ka qasje ne daten e matjes.
- Niveli 2: Kjo kategori perfshin instrumente te vleresuara duke perdorur: çmimet e kuotuar te tregut ne tregjet aktive per instrumente te ngjashme; çmimet e kuotuar per instrumente te ngjashme ne tregje qe konsiderohen me pak se aktive; ose teknika te tjera vleresimi ku te gjithë inputet e rendesishme jane direkt ose indirekt te vezhgueshme nga te dhenat e tregut.
- Niveli 3: Kjo kategori perfshin gjithë instrumentet ku teknikat e vleresimi perfshijne inpute te cilat nuk bazohen ne te dhena te vezhgueshme dhe inputet e pavezhgueshme mund te kete nje efekt te rendesishem ne vleresimin e instrumentit. Kjo kategori perfshin instrumente qe jane vleresuar ne baze te çmimeve te kuotuar per instrumente te ngjashme, ku rregullime te rendesishme te pavezhgueshme ose supozime jane te nevojshme per te reflektuar diferencat midis instrumenteve.

4. POLITIKAT KRYESORE KONTABEL (VAZHDIM)

4.18. Matja e vleres se drejte (vazhdim)

Kur eshte e mundur, Banka mat vleren e drejte te nje instrumenti duke perdorur çmim te kuotuar ne nje treg aktiv per ate instrument. Nje treg quhet aktiv ne qofte se transaksionet ne lidhje me aktivin apo detyrimin zhvillohen me frekuence dhe volum te mjaftueshme per te siguruar informacion te çmimeve ne baza te vazhdueshme. Nese nuk ekziston nje çmim i kuotuar ne nje treg aktiv, atehere Banka perdor teknika vleresimi te cilat maksimizojne perdorimin te inputeve perkatese te vezhgueshme dhe minimizojne perdorimin e inputeve jo te vezhgueshme. Teknika e zgjedhur e vleresimit perfshin te gjithe faktoret qe pjesemarresit ne treg do te kishin parasysh ne vendosjen e çmimit te nje transaksioni. Vlera e drejte tregohet ne Shenimin 38.

Evidenca me e mire e vleres se drejte te nje instrumenti financiar ne njohjen fillestare te tij eshte zakonisht çmimi i transaksionit - dmth vlera e drejte e konsiderates se dhene ose te marre. Nese Banka percakton se vlera e drejte ne njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit dhe se vlera e drejte nuk eshte evidentuar as me nje çmim te kuotuar ne nje treg aktiv per nje aktiv ose detyrim identik e as nuk eshte e bazuar ne nje teknike vleresimi e cila perdor vetem te dhena nga tregjet e vrojtueshme, atehere instrumenti financiar matet fillimisht me vleren e drejte, rregulluar per te shtyre ne kohe diferencen midis vleres se drejte ne njohjen fillestare dhe çmimit te transaksionit. Me pas, kjo diference eshte njohur ne fitim ose humbje ne nje baze te pershtatshme mbi jetegjatesine e instrumentit, por jo me vone se vleresimi qe mbeshitet plotesisht nga te dhena te vezhgueshme te tregut ose kur transaksioni mbyllet.

Ne qofte se nje aktiv ose detyrim te matur me vleren e drejte ka nje çmim te ofruar dhe nje çmim te kerkuar, atehere Banka mat aktivet dhe pozicionet e gjata ne çmimin e ofruar dhe detyrimet dhe pozicionet e shkurtra ne çmim e kerkuar. Vlera e drejte e nje llogarie kursimi nuk eshte me pak se shuma e pagueshme sipas kerkeses, skontuar nga data e pare kur mund te kerkohet pagimi i shumes. Banka njeh transferimet midis niveleve te hierarkise se vleres se drejte deri ne fund te periudhes raportuese gjate te ciles ky ndryshim ka ndodhur.

4.19. Paraja dhe ekuivalentet e saj

Paraja dhe ekuivalentet e saj perfshijne para ne arke, balanca ne Banken Qendrore te pakufizuara ne perdorim dhe aktive financiare shume likuide me maturim fillestar deri ne tre muaj te cilat, kane rrezik te pakonsiderueshem ndryshimi te vleres se tyre te drejte, dhe perdoren nga Banka per menaxhimin e angazhimeve afatshkurtra.

Paraja dhe ekuivalentet e saj mbahen me kosto te amortizuar ne pasqyren e veçante te pozicionit financiar.

4.20. Depozita dhe llogari me bankat dhe Hua dhe paradhenie per klientet

“Depozita dhe llogari me bankat” dhe “Hua dhe paradhenie per klientet” ne pasqyren e pozicionit financiar, perfshijne hua dhe paradhenie te matura me koston e amortizuar (Shenimi 4.8.4). Fillimisht ato maten me vleren e drejte plus kostot direkte te transaksionit, dhe me pas me koston e amortizuar duke perdorur metoden e normes efektive te interesit.

Kur Banka blen nje aktiv financiar dhe njeheresh hyn ne nje marreveshje per ta rishitur kete aktiv (ose nje aktiv thelbesisht te ngjashem) me nje çmim fiks ne nje date te ardhshme (repo te anasjellta), marreveshja kontabilizohet si nje hua apo paradhenie dhe aktivi i lidhur me te nuk njihet ne pasqyrat e veçante financiare te Bankes.

4.21. Letra me vlere investimi

“Letra me vlere investimi” perfshijne letra me vlere qe maten me koston e amortizuar (Shenimi 4.8.4). Letrat me vlere investimi maten me vleren e drejte plus kostot direkte te transaksionit, dhe me pas me koston e amortizuar duke perdorur metoden e normes efektive te interesit.

4.22. Qirate

Politika e zbatueshme nga 1 janar 2019 (SNRF 16)

Banka vlereson ne lindjen e kontrates nese nje kontrate eshte apo permban nje qira. Qe do te thote nese kontrata jep te drejten per te kontrolluar perdorimin e nje aktivi te identifikuar per nje periudhe kohe ne kembim te nje shume.

4. POLITIKAT KRYESORE KONTABEL (VAZHDIM)

4.22. Qirate (vazhdim)

4.22.1. Banka si qiramarrese

Banka zbaton nje qasje te vetme per njohjen dhe matjen e te gjitha qirave me perjashtim te qirave afatshkurtra dhe qirave te aktiveve me vlere te vogel. Banka njeh detyrimin per qirate per te kryer pagesat e qirave dhe te drejten e perdorimit te aktivitet qe perfaqeson te drejten per te perdorur aktivin baze.

4.22.1.1. Aktiv me te drejte perdorimi

Banka njeh aktiv me te drejte perdorimi ne daten e fillimit te qirase (data ne te cilen aktivi baze eshte i vlefshem per t'u perdorur). Aktivi me te drejte perdorimi matet me kosto, duke i zbritur ndonje amortizim te akumuluar apo ndonje humbje nga zhvleresimi, dhe te rregulluar per ndonje rimatje te detyrimit per qira. Kosto e aktivitet me te drejte perdorimi perfshin vleren e detyrimit per qira te njohur, kostot e drejtperdrejta fillestare te kryera, dhe pagesat e qirave te kryera ne apo para dates se fillimit te qirase, pakesuar me çdo stimuj qiraje te marre. Aktivi me te drejte perdorimi amortizohet ne baze lineare gjate jetes se qirase. Aktivitet me te drejte perdorimi paraqiten brenda Shenimit 14.1.1.

4.22.1.2. Detyrime per qira

Banka njeh detyrimin per qira ne daten e fillimit te qirase, te matur si vlere aktuale e pagesave per t'u kryer te qirave gjate gjithë jetes se qirase. Pagesat e qirave perfshijne pagesat fikse (pakesuar me ndonje stimuj te marre per qirate), pagesat e ndryshueshme te qirase qe varen ne nje indeks ose nje norme, dhe pagesat e pritshme sipas vleres se mbetur te garancive. Pagesat e qirase gjithashtu perfshijne dhe çmimin e ushtrimit të nje opsioni blerjeje nese Banka ka siguri ne arsyeshme ne ushtrimin e tij dhe pagesat e gjobave per perfundimin e qirase, nese afati i qirase reflekton ushtrimin e nje opsioni per perfundimin e qirase. Qirate e ndryshueshme te cilat nuk varen nga nje indeks apo norme, njihen si shpenzime te periudhes ne te cilen ndodh ngjarja apo kushtet per shkaktimin e tyre.

Banka ne perlogaritjen e vleres aktuale te pagesave te qirase perdor normen rritese te huamarrjes ne daten e fillimit te qirase, pasi norma e interesit e percaktuar e qirase nuk mund te jete lehtesisht e gjetshme. Pas dates se fillimit, vlere e detyrimit per qira rritet per te reflektuar interesin ne detyrimin e qirase dhe pakesohet per te reflektuar pagesat e kryera te qirase. Pervec kesaj, vlere kontabel e detyrimit per qira rimatet nese ka nje modifikim, nje ndryshim ne afatet e qirase, nje ndryshim ne pagesat e qirase (psh. ndryshim i pagesave te ardhshme qe rezultojne nga nje ndryshim ne indeks ose norme te perdorur per te percaktuar keto pagesa te qirave) ose ndryshim ne vleresimin e opsionit per te blere aktivin baze. Kur detyrimi per qira rimatet ne kete menyre, regjistrohet dhe nje rregullim korrespondues i vleres kontabel te aktivitet me te drejte perdorimi, ose regjistrohet ne fitim humbje ne rast se vlere kontabel e aktivitet me te drejte perdorimi eshte zero.

Detyrimet per qirate paraqiten ne nje ze me vete ne bilancin e veçante te Bankes dhe shpalosen ne Shenimin 14.1.2.

4.22.1.3. Qirate afatshkurtra dhe qirate e aktiveve me vlere te ulet

Banka zbaton lehtesirat e njohjes per qirate afatshkurtra per qirate e disa degeve te saj (ato qira te kane maturimin deri ne 12 muaj nga data e fillimit dhe nuk kane nje opsion per blerje). Po ashtu zbaton dhe lehtesirat e njohjes per disa pajisje zyre te cilat jane konsideruar si me vlere te ulet. Pagesat e qirase per qirate afatshkurtra dhe ato te aktiveve me vlere te ulet njihen si shpenzime gjate afatit te kontratave te qirave perkatese.

4.22.2. Banka si qiradhenese

Qirate ne te cilat Banka nuk transferon ne menyre te konsiderueshme te gjitha rreziqet dhe perfitimet e pronesise se aktivitet baze klasifikohen si qira operationale. Te ardhurat nga keto qira njihen ne baze lineare pergjate jetes se qirase dhe perfshihen ne te ardhurat ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve per shkak te natyres se tyre operationale. Kostot fillestare direkte te bera per te negociuar dhe perfunduar nje qira operationale i shtohen vleres kontabel te aktivitet baze dhe njihen si shpenzim gjate jetes se qirase ne te njejten baze si e ardhura e qirase. Te ardhurat nga qirate ne kontigjence njihen ne periudhen ne te cilen ato jane fituar.

4. POLITIKAT KRYESORE KONTABEL (VAZHDIM)

4.22. Qirate (vazhdim)

4.22.3. Nenqiraja

Banka ne disa raste eshte nenqiradhenese (qiradhenes i ndermjetem) i aktivitet me te drejte perdorimi. Si nje qiradhenes i ndermjetem, Banka e klasifikon nenqirane si nje qira financiare apo operacionale si me poshte:

- Nese qiraja kryesore eshte qira afatshkurter qe Banka, si qiramarrrese, e ka njohur si te tille, nenqiraja klasifikohet si qira operacionale,
- Ne te kundert, nenqiraja klasifikohet duke iu referuar aktivitet me te drejte perdorimi qe vjen nga qiraja kryesore, dhe jo duke iu referuar aktivitet baze. Nje qira klasifikohet si qira financiare nese transferon ne menyre te konsiderueshme te gjitha rreziqet dhe perfitimet e pronesise nga aktivitet me te drejte perdorimi qe rrjedhin nga qiraja kryesore; ne te kundert, ajo klasifikohet si nje qira operacionale.

Per nenqirate te klasifikuara si qira financiare, Banka çregjistron Aktivitet me te drejte perdorimi dhe nje Investimin neto ne nenqira; çdo diference midis Aktivitet me te drejte perdorimi dhe Investimit neto ne nenqira, njihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Ne daten e fillimit, Investimi neto ne nenqira financiare matet me nje vlerë te barabarte me vleren aktuale te pagesave te qirase te Aktivitet me te drejte perdorimi baze pergjate afatit te qirase.

Investimi neto ne qira paraqitet nen “Aktive te tjera” ne pasqyren e veçante te pozicionit financiar.

Per nenqirate e klasifikuara si qira operacionale, Banka njeh te ardhurat nga qiraja financiare ne baza lineare pergjate afatit te qirase. Aktivitet respektiv i dhene me qira perfshihet ne pasqyren e pozicionit financiar bazuar ne natyren e tij.

Politika e zbatueshme para 1 janar 2019

Percaktimi nese nje marreveshje eshte nje qira ose permban nje qira, bazohet ne substancen e marreveshjes dhe kerkon nje vleresim nese permbushja e marreveshjes eshte e varur ne perdorimin e nje aktivitet specifik ose nese marreveshja percjell nje te drejte te perdorimit te aktivitet.

4.22.4. Banka si qiramarrrese (Politika e zbatueshme perpara 1 janar 2019)

Qirate qe nuk i transferojne Bankes ne menyre te konsiderueshme te gjitha rreziqet dhe perfitimet e rastesishme nga pronesia e aktiveve te marra me qira jane qira operacionale. Pagesat e qirase operacionale njihen si shpenzime ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve ne baza lineare gjate jetes se qirase. Pagesat kontigjente te qirase njihen si shpenzime ne periudhen ne te cilen ato ndodhin.

4.22.5. Banka si nje qiradhenese (Politika e zbatueshme perpara 1 janar 2019)

Qirate ne te cilat Banka nuk transferon ne menyre te konsiderueshme te gjitha rreziqet dhe perfitimet e pronesise se aktivitet klasifikohen si qira operacionale. E ardhura nga qiraja njihet kur fitohet bazuar ne kushtet e kontrates se qirase ne Te ardhura te tjera operacionale. Kostot fillestare te drejteperdrejta te ndodhura gjate negociimit te qirase operacionale i shtohen vleres kontabel te aktivitet te marre me qira dhe njihen gjate afatit te qirase ne te njejten baze si e ardhura nga qiraja. Te ardhurat nga qirate ne kontigjence njihen ne periudhen ne te cilen ato jane fituar.

4.23. Aktive te qendrueshme te trupezura

4.23.1. Njohja dhe matja

Zerat e aktiveve te qendrueshme te trupezuara maten me kosto pakesuar me amortizimin e akumuluar dhe ndonje zhvleresim te akumuluar per humbje.

Kosto perfishin shpenzime te cilat i atribuohen direkt blerjes se aktivitet. Kosto e aktiveve te ndertuara vete perfishin dhe koston e materialeve dhe punen direkte, kosto te tjera direkt te atribueshme ne berjen e aktivitet te gatshem per pune, dhe kur Banka ka detyrimin per te hequr nje aktiv apo ta restauroje ate, kosto e vleresuar e çmontimit dhe heqjes se pjese si dhe restaurimi i vendit ne te cilin ato ndodhen. Programet kompjuterike qe jane pjese e funksionimit te pajisjes ne te cilen ato jane instaluar, kapitalizohen si pjese e asaj pajisjeje.

Ne rast se pjese te nje aktivitet kane afate perdorimi te ndryshme, ato regjistrohen si njesi me vete (perberesit kryesore) te aktiveve te trupezuara.

4. POLITIKAT KRYESORE KONTABEL (VAZHDIM)

4.23. Aktive te qendrueshme te trupezuara (vazhdim)

4.23.1. Njohja dhe matja (vazhdim)

Te ardhurat apo humbjet nga nxjerrja jashte perdorimit te nje aktivi te trupezuar (llogaritur si diference midis arketimeve nga nxjerrja jashte perdorimit dhe vleres kontabel te aktivitet) njihen si te ardhura te tjera ne pasqyren e fitim humbjeve.

4.23.2. Kostot e mepasshme

Shpenzimet e mepasshme kapitalizohen vetem nese eshte e mundshme qe perfitimet ekonomike qe i atribuohen atyre do te rrjedhin te Banka ne te ardhmen. Te gjitha kostot e tjera te riparimit dhe mirembajtjes regjistrohen ne shpenzimet kur ndodhin.

4.23.3. Amortizimi

Aktivet e qendrueshme te trupezuara amortizohen duke filluar nga dita qe ato jane vene ne perdorim, ose persa i perket aktiveve te ndertuar vete, nga dita e perfundimit dhe e berjes gati per perdorim. Amortizimi llogatitet per te gjithë jeten e aktivitet mbi koston e asetit minus vleren e tij te mbetur. Amortizimi njihet ne pasqyren e fitim humbjeve.

Amortizimi i vitit eshte llogaritur sipas metodes se vleres se mbetur ne perputhje me normat e meposhtme:

	Norma vjetore
Paisje kompjuterike	25%
Paisje zyre	20%
Paisje elektronike dhe elektrike	20%
Instalime	20%

Permiresimet ne ambjentet e marra me qira nga Banka amortizohen duke perdorur metoden lineare gjate kohes me te shkurter midis afatit te qirase dhe jetes se tyre. Afati i perdorimit te ketyre permiresimeve varion nga 3 ne 15 vjet. Aktivet ne proces nuk amortizohen. Metodat e amortizimit, jeta dhe vlera e tyre e mbetur rishikohen ne çdo date raportimi dhe axhustohen ne rast se ka nevojë.

4.24. Aktive te qendrueshme te patrupezuara

Programet kompjuterike te blera nga Banka maten me kosto duke i zbritur amortizimin e akumuluar dhe zhvleresimin kur eshte i aplikueshem. Shpenzimet e mepasshme ne programe kompjuterike kapitalizohen vetem nese ato rrisin perfitimet ekonomike te ardhshme te aktivitet per te cilin behen. Te gjitha shpenzimet e tjera regjistrohen kur ndodhin.

Amortizimi njihet ne fitim humbje gjate jetes se dobishme te aktivitet, duke u nisur nga data ne te cilen eshte i vlefshem per pune. Aktivet ne proces nuk amortizohen.

Programet kompjuterike amortizohen sipas metodes se vleres se mbetur me norme vjetore amortizimi 25%, nderkohe aktivet e tjera te patrupezuara, qe perfshijne licenca dhe komisione te paguara per qasje ne sisteme elektronike e sherbime te perdorura nga Banka, amortizohen sipas metodes lineare me norme vjetore amortizimi 15%.

Metodat e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e tyre e mbetur rishikohen ne çdo date raportimi dhe axhustohen ne rast se ka nevojë.

4.25. Investime ne pasurite e paluajtshme

Investimet ne pasuri te paluajtshme jane aktive te mbajtura ose per te fituar te ardhura nga qiraja ose per rivlersime te vleres se tyre ose per te dyja, por jo per perdorim ne prodhim apo furnizim me te mira materiale, sherbime apo per qellime administrative. Banka mban investime ne pasurite e paluajtshme si pasoje e perfitimit te tyre nepermjet ekzekutimit te kolateraleve mbi kredite dhe paradheniet ndaj klienteve. Pasurite e paluajtshme per investim matem fillimisht me kosto dhe me pas me vleren e drejte, ku çdo ndryshim i tyre njihet ne pasqyren e fitimit ose humbjes ne zerin “te ardhura te tjera”.

Çdo fitim apo humbje e gjeneruar gjate shitjes se pasurive te paluajtshme te mbajtura per investim (te llogaritur si diference midis te ardhurave nga shitja dhe vleres kontabel te ketij aktivi) njihet ne pasqyren e fitimit ose humbjes. Ne rast se perdorimi i ketij aktive ndryshon ne menyre te tille qe riklasifikohet si aktiv i qendrueshem i trupezuar ose aktiv i mbajtur per shitje, vlera e drejte e tij ne momentin e riklasifikimit behet kosto e tij per regjistrimet kontabel te mepasshme.

4. POLITIKAT KRYESORE KONTABEL (VAZHDIM)

4.26. Inventaret dhe kolateralet e marra ne pronesi

Inventaret dhe kolateralet e marra ne pronesi fillimisht maten me kosto dhe me pas me me te voglen e koston dhe vleres neto te realizueshme ("VNR"). Kosto perfshin te gjitha koston e blerjes, koston e konvertimit dhe koston te tjera qe mund te ndodhin per te sjelle inventarin te vendndodhjen aktuale. Vlera neto e realizueshme eshte çmimi i vleresuar i shitjes gjate nje shtate normale biznesi, pakesuar me koston e vleresuara per realizimin dhe ato te vleresuara te nevojshme per te bere shitjen.

Inventaret perfshihen nen Aktive te tjera ne pasqyren e vecante te pozicionit financiar. Banka mban inventaret ne formen e inventareve per konsum. Inventaret per konsum jane materiale te blera me qellim konsumin e tyre gjate ofrimit te sherbimeve bankare.

Kolateralet e marra ne pronesi jane pasuri te paluajtshme te perfituara nepermjet ekzekutimit te kolateraleve mbi kredite dhe paradhenieve te klienteve. Per transferimet nga Investime ne pasuri te paluajtshme qe mbahen me vlera te drejte tek Inventaret, si kosto per kontabilizimin ne kete kategori do te jete vlera e drejte ne daten ne te cilen behet transferimi.

Çdo zvogelim ne VNR njihet si nje shpenzim ne periudhen net e cilen ky zvogelim ndodh; çdo rimarrje njihet ne pasqyren e veçante te te ardhurave dhe shpenzimeve ne periudhen ne te cilen rimarrja ndodh.

4.27. Humbja nga zhvleresimi i aktiveve jofinanciare

Vlera kontabel e aktiveve jofinanciare te Bankes, pervec tatimeve te shtyra, rishikohen çdo date raportimi per te percaktuar nese ka ndonje tregues per zhvleresim. Ne rast se ka nje tregues te tille, atehere vleresohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Humbja nga zhvleresimi njihet ne rast se vlera kontabel e aktivitetit eshte me e madhe se vlera e tij e rikuperueshme.

Vlera e rikuperueshme e nje aktiviteti eshte vlera me e madhe midis vleres ne perdorim dhe vleres se drejte duke zbritur koston per shitje. Ne percaktimin e vleres ne perdorim, flukset e vleresuara te pritshme te parase jane skontuar ne vleren e tyre aktuale duke perdorur nje norme skontimi para taksave qe reflekton vleren ne kohe te parase ne treg dhe risqet specifike te aktivitetit. Humbjet per zhvleresim njihen ne pasqyren e veçante te fitim humbjeve. Humbja per zhvleresim kthehet mbrapsht deri ne masen qe vlera kontabel nuk kalon vleren e mbartur te aktivitetit, neto nga zhvleresimet e amortizimet, e cila do te ishte ne rast se nuk do te ishin njohur humbje nga zhvleresimi.

4.28. Depozitat dhe marreveshjet e riblerjes

Depozitat dhe marreveshjet e riblerjes jane burimet e Bankes per financim.

Kur Banka shet nje aktiv financiar dhe njeheresh hyn ne nje marreveshje per te riblere kete aktiv (ose nje aktiv te ngjashem) me nje çmim fiks ne nje date te ardhshme (repo), marreveshja kontabilizohet si nje detyrim financiar, dhe aktiviteti vazhdon te njihet ne pasqyrat financiare te veçante te Bankes.

4.29. Provizionet

Provizioni eshte njohur nese, si rezultat i ngjarjeve te meparshme, Banka ka nje detyrim ligjor ose konstruktiv qe mund te matet me besueshmeri, dhe eshte e mundur qe nje dalje e perfitimeve ekonomike do te kerkohet per te shlyer detyrimin. Provizionet jane percaktuar duke skontuar flukset e pritshme te ardhshme te mjeteve monetare me nje norme para tatimit e cila reflekton vleresimet aktuale te tregut per vleren ne kohe te parase dhe, sipas rastit, rreziqet specifike ndaj detyrimit. Efektet e vleres kohore nepermjet skontimeve njihen si kosto financiare.

4.30. Garancite Financiare, leterkredite dhe angazhimet e paterhequra per kredite

Si pjese e biznesit te saj, Banka leshon garanci financiare, te perbere nga letra kredie, garanci dhe pranime.

Garancite financiare fillimisht njihen ne pasqyrat financiare (brenda Provigjoneve) me vlera te drejte, duke gene primi i marre. Pas njohjes fillestare, detyrimi i Bankes sipas seciles garanci matet me vleren me te madhe mes shumës se njohur fillimisht pakesuar me amortizimin kumulativ te njohur ne pasqyren e te ardhurave dhe nje fond zhvleresimi ECL sic percaktohet ne Shenimin 36.

Primi i marre njihet ne pasqyren e te ardhurave ne Te ardhurat nga komisionet ne perpjesetim te drejte gjate jetes se garancise.

Angazhimet per kredi dhe letrat e kredive jane angazhime nen te cilat, gjate kohezgjatjes se angazhimit, Bankes i kerkohet te ofroje nje hua me terma te paracaktuar per klientin. Ngjashem me kontratat e garancise financiare keto kontrata jane ne kuader te kerkesave te ECL.

4. POLITIKAT KRYESORE KONTABEL (VAZHDIM)

4.30. Garancite Financiare, leterkredite dhe angazhimet e paterhequra per kredite (vazhdim)

Vlera nominale kontraktuale e garancive financiare, letrave te kreditit dhe angazhimeve te kredise, ku huate e dakorduara per t'u ofruar jane ne terma te tregut, nuk regjistrohen ne pasqyren e pozicionit financiar. Vlerat nominale te ketyre instrumenteve se bashku me ECL-te perkatese jane shpalosur ne Shenimin 36.

4.31. Perfitimet e punonjesve

Planet e percaktuara te kontributeve

Detyrimet per kontributet per planet e percaktuara te pensioneve njihen si nje shpenzim ne fitim ose humbje kur ato ndodhin. Banka paguan kontribute te detyrueshme per sigurimet shoqerore per perfitimet e punonjesve qe dalin ne pension. Autoritetet lokale jane pergjegjese per percaktimin e limitit minimal ligjor te vendosur per pensionet ne Shqiperi sipas nje plani kontributesh pensioni te percaktuar.

Perfitimet afatshkurtra

Detyrimet afatshkurtra per perfitimet e punonjesve maten ne nje baze te paskontuar dhe njihen si shpenzime kur ofrohet sherbimi. Nje provigjon eshte njohur per shumen qe pritet te paguhet si bonus afatshkurter ne para ose planeve me ndarje fitimi nese Banka ka nje detyrim ligjor ose konstruktiv per te paguar kete shume si rezultat i sherbimeve te shkuara te ofruara nga punonjesi, dhe detyrimi mund te matet me besueshmeri.

4.32. Adaptimi i standarteve dhe interpretimeve te reja dhe te rishikuara

Standartet e meposhtme, te cilat jane kryesisht amendime te standarteve ekzistuese dhe interpretime te nxjerra nga Bordi Nderkombetar i Standarteve Kontabel jane efektive per periudhen aktuale, por adaptimi i tyre nuk ka sjelle ndonje ndryshim ne politikat kontable te Bankes:

- **KIRFN 23 "Pasiguria mbi Trajtimin e Taksave mbi te Ardhurat"** (efektive per periudhat vjetore qe fillojne me ose pas 1 janarit 2019),
- **Ndryshimet ne SNRF 9 "Instrumentet Financiare"** - Karakteristikat e Parapagimit me Kompensim Negativ (efektiv per periudhat vjetore qe fillojne me ose pas 1 Janarit 2019),
- **Ndryshimet ne SNK 19: Amendamenti i Planit, Reduktimi ose Zgjidhja** - kontabilizimi kur nje ndryshim, shkurtim ose shlyerje plani ndodh gjate nje periudhe raportuese (efektive per periudhat vjetore qe fillojne me ose pas 1 janarit 2019),
- **Ndryshimet ne SNK 28 "Investimet ne Shoqerite dhe Siper marrjet e Perbashketa"** - Interesat Afatgjate ne Shoqerite dhe Siper marrjet e Perbashketa (efektive per periudhat vjetore qe fillojne ne ose pas 1 janar 2019),

4.33. Impakti i standarteve te reja ende te pa adaptuara

Standartet e reja dhe te rishikuara dhe interpretimet qe jane leshuar por qe ende nuk jane efektive deri ne daten e leshimit te ketyre pasqyrave te Bankes, jane dhene me poshte. Banka ka per qellim te adaptoje keto standarte te reja dhe te rishikuara, nese jane te aplikueshme, kur te behen efektive.

- **SNRF 17: Kontratat e Sigurimeve"** (efektive per periudhat qe fillojne me ose pas 1 janarit 2023),

SNRF 17 zbatohet per te gjitha llojet e kontratave te sigurimit (te sigurimit te jetes dhe te tjera si dhe te sigurimit te drejtperdrejte dhe ato te risigurimit), pavaresisht nga lloji i njesive ekonomike qe i lesojne ato, si dhe per disa garanci dhe instrumente financiare me karakteristika diskrecionale te pjesemarrjes. Do aplikohen disa perjashtime nga fusha e veprimit.

SNRF 17 ofron nje model gjithepershires per kontratat e sigurimit, duke mbuluar te gjitha aspektet perkatese te kontabilitetit. Thelbi i SNRF 17 eshte model i pergjithshem, i plotesuar me:

- Nje pershtatje specifike per kontratat me tipare te pjesemarrjes direkte (qasja e tarifes se ndryshueshme)
- Nje qasje e thjeshtuar (qasja e alokimit te primit) kryesisht per kontratat me kohezgjatje te shkurter.

4. POLITIKAT KRYESORE KONTABEL (VAZHDIM)

4.33. Impakti i standarteve te reja ende te pa adaptuara (vazhdim)

Matja e vleres aktuale te flukseve monetare te ardhshme, duke perfshire nje rregullim per rrezikun, e rimatur cdo periudhe raportuese (permbushja e flukseve te parase). Nje marzh i kontraktuar sherbimi (CSM) qe eshte e barabarte dhe e kundertra e cdo fitim te dites se pare ne permbushjen e flukseve te parase ne nje grup kontratash, qe perfaqesojne fitimin e pafituar te kontratave te sigurimit qe do te njihen ne fitim ose humbje gjate periudhes se sherbimit (periudhes se sigurimit). Ndryshime te caktuara ne vleren aktuale te pritshme te flukseve te ardhshme te parave rregullohen kundrejt CSM dhe ne kete menyre njihen ne fitim ose humbje gjate periudhes kontraktuale te mbetur te sherbimit.

- **Permiresime ne SNK 16 "Aktivet afatgjata materiale" – Te ardhurat para perdorimit** (efektive per periudhat vjetore qe fillojne me ose pas 1 janarit 2022),

Ndryshimi ndalon njesite ekonomike te zbresin nga kosto e nje elementi te aktiveve afatgjata materiale, te gjitha te ardhurat nga shitja e artikujve te prodhuar ndersa e sjellin ate aktiv ne vendin dhe gjendjen e nevojshme qe ai te jete i afte te operoje sic pritet nga menaxhimi. Ne vend te kesaj, nje njesi ekonomike njeh te ardhurat nga shitja e artikujve te tille dhe kostot e prodhimit te ketyre artikujve ne fitim ose humbje. Ndryshimi duhet te zbatohet ne menyre retrospektive vetem per zerat e aktiveve te vena ne dispozicion per perdorim ne ose pas periudhes me te hershme kur njesia ekonomike zbaton per here te pare ndryshimin.

- **SNRF 9 Instrumentet financiare – tarifate ne testin e “10 per qind” per crregjistrimin e detyrimeve financiare**, efektive ne ose pas 1 janar 2022

Ndryshimi sqaron tarifate qe nje njesi ekonomike perfshin kur vlereson nese kushtet e nje detyrimi te ri apo te modifikuar financiar jane thelbesisht te ndryshme nga kushtet e detyrimit financiar fillestar. Keto tarifa perfshijne vetem ato te paguara ose te marra ndermjet huamarresit dhe huadhenesit, duke perfshire dhe tarifate e paguara ose te marra dhe ne emer te secilit prej tyre. Nuk ka ndryshime te ngjashme te propozura per SNK 39.

Nje njesi ekonomike zbaton ndryshimin ne detyrimet financiare qe modifikohen apo shkembehen ne apo pas fillimit te periudhes raportuese ne te cilen kjo njesi aplikon per here te pare kete ndryshim.

- **Ndryshim ne SNRF 16: Koncesionet e qirave qe lidhen me Covid-19**, efektive me ose pas 1 qershor 2020

Si nje lehtisim praktik, nje qiramarres mund te zgjedhe te mos vleresoje nese nje koncesion qiraje ne lidhje me Covid-19 nga nje qiradhenes, perben nje modifikim te qirase. Nje qiramarres qe zgjedh kete mundesi llogarit per cdo ndryshim ne pagesat e qirase qe rezultojne nga koncesioni prej Covid-19 ne te njejten menyre qe do te llogariste ndryshimin spas SNRF 16 ne ky ndryshim nuk do te ishte nje modifikim i qirase.

Kjo lehtesi praktike zbatohet vetem per koncesionet e qirase qe ndodhin si pasoje e drejperdrejte e pandemise se Covid-19 dhe vetem nese plotesohen te gjitha kushtet e meposhtme:

- Ndryshimi ne pagesat e qirase rezulton ne nje konsiderate te rishikuar per qirane qe eshte ne thelb e njejte me, ose me pak se konsiderata per qirane menjehere para ndryshimit
- Cdo ulje e pagesave te qirase ndikon vetem ne pagesat qe ishin fillimisht per t'u paguar para 30 qershorit 2021(per shembull, nje koncesion qiraje do te plotesonte kete kusht nese rezulton ne pagesa te reduktuara te qirase para 30 qershorit 2021 dhe rritje te pagesave te qirase qe shtrihen pertej 30 qeshorit 2021).
- Nuk ka ndryshime thelbesore ne termat dhe kushtet e qirase

Qiradhenesit do te zbatojne lehtesirat praktike ne menyre retrospective, duke njohur efektin e akumuluar te zbatimit fillestar si nje rregullim i balances hapese te fitimeve te mbartura(apo zerave te tjere te kapitalit, sipas rastit) ne fillim te periudhes vjetore raportuese ne te cilen ndryshimi ne fjale zbatohet per here te pare.

- **Ndryshimet ne SNK 1: Klasifikimi i detyrimeve si Korrente dhe Jo-korrente**, efektive ne dhe pas 1 janar 2022

E drejta per te shtyre likuidimin

Nese e drejta e nje njesie ekonomike per te shtyre likuidimin e detyrimit eshte e realizueshme nepermejt permbushjes te kushteve specifike, njesia ekonomike ka te drejte te shtyje likuidimin e detyrimit ne fund te periudhes raportuese nese ajo eshte ne perputhje me ato kushte ne ate date.

4. POLITIKAT KRYESORE KONTABEL (VAZHDIM)

4.33. Impakti i standarteve te reja ende te pa adaptuara (vazhdim)

Ekzistenca ne fund te periudhes raportuese

Ndryshimet gjithashtu sqarojne se kerkesat per te drejten e ekzistences ne fund te periudhes raportuese aplikohen pavaresisht nese huadhenesi teston per pajtuesmeri ne ate apo ne nje date te mevonshme.

Pritshmerite e menaxhimit

SNK 1.75A eshte shtuar per te sqaruar se ‘klasifikimi i nje detyrimi nuk preket nga gjasat qe njesia ekonomike te ushtroje te drejten e saj per te shtyre shlyerjen e detyrimit per te pakten dymbedhete muaj pas periudhes se raportimit’. Pra, qellimi i menaxhimit per te shlyer ne nje periudhe afatshkurter, nuk ndikon ne klasifikim. Kjo vlen edhe nese shlyerja ka ndodhur kur pasqyrat financiare jane autorizuar per t’u leshuar.

- **Ndryshimet ne SNRF 3: Perkufizimi i biznesit**, efektive ne ose pas 1 janar 2020.
- **Ndryshimet ne SNRF 3: Korniza konceptuale ne standartet e SNRF**, efektive me ose pas 1 janarit 2022.
- **Ndryshimet ne SNK 37: Kontratat – Kostot e permbushjes se nje kontrate**, efektive me ose pas 1 janarit 2022.
- **Ndryshime ne SNRF 1 Adaptimi per here te pare te Standarteve Nderkombetare te Raportimit Financiar – Filiali si adaptues per here te pare**, efektive me ose pas 1 janarit 2022.
- **Ndryshime ne SNK 41 Bujqesia – Taksimi ne matjen e vleres se drejte**, efektive me ose pas 1 janarit 2022.
- **Ndryshime ne SNRF10 dhe SNK 28 – Shitja ose Kontributi ne Aktive ndermjet Investitorit dhe ortakut apo ndermarrjes se perbashket.**

5. PERDORIMI I VLERSIMEVE DHE GJYKIMEVE

Pergatitja e pasqyrave financiare te vecanta ne perputhje me SNRF kerkon nga menaxhimi qe te beje gjykime, vleresime dhe supozime te cilat ndikojne ne aplikimin e politikave kontabel dhe shumat e raportuara te aktiveve dhe detyrimeve, te ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund te ndryshojne nga keto vleresime.

Vleresimet dhe supozimet e lidhura me to rishikohen vazhdimisht. Rishikimet ndaj vleresimeve kontabel njihen ne periudhen ne te cilen ndodh rishikimi dhe ato te ardhshme te cilat mund te preken nga ky ndryshim. Menaxhimi diskuton me Komitetin e Auditimit, zhvillimin, zgjedhjen dhe paraqitjen e politikave kritike kontabel te Bankes dhe aplikimin e tyre, si dhe supozimet e bera ne lidhje me paqartesite kryesore te vleresimit. Informacioni rreth pasigurise se supozimeve dhe vleresimeve qe kane nje rrezik te konsiderueshem per te rezultuar ne nje rregullim material brenda vitit te ardhshem financiar, dhe rreth gjykimeve kritike ne aplikimin e politikave kontabel qe kane efekt te konsiderueshem ne vlerat kontabel ne pasqyrat financiare te vecanta eshte sqaruar me poshte.

Keto shenime shpjeguese mbeshtesin komentet mbi administrimin e rrezikut financiar (shih shenimin 37).

5.1. Vleresimi i modelit te biznesit

Klasifikimi dhe matja e aktiveve financiare varen nga rezultatet e testeve SPPI dhe modelit te biznesit te Bankes. Banka percakton modelin e biznesit ne nje nivel qe reflekton menyren sesi grupe te aktiveve financiare menaxhohen se bashku per te arritur nje objektivi te caktuar te biznesit. Ky vleresim perfshin gjykime qe reflektojne te gjitha evidencat e vlefshme duke perfshire dhe menyren e vleresimit te performances se nje aktivi dhe matjen e saj, rreziqet qe ndikojne performancen e aktiveve financiare dhe se si keto menaxhohen, dhe si menaxheret e aktiveve kompesohen. Banka monitoron aktivet financiare te matura me koston e amortizuar te cilat jane cregjistruar para dates se maturimit per te kuptuar arsyen e ketij cregjistrimi dhe nese arsyet jane konsistente me objektivin e biznesit per te cilin eshte mbajtur ky aktiv. Monitorimi eshte pjese e vleresimit te vazhdueshem te Bankes per te pare nese modeli i biznesit nen te cilin mbahen pjesa e mbetur e aktiveve financiare vazhdon te jete i pershtatshem dhe nese nuk eshte i tille, nese ka patur nje ndryshim ne modelin e biznesit dhe ne kete menyre ne vazhdim te ndryshoje klasifikimin e ketyre aktiveve.

5. PERDORIMI I VLERSIMEVE DHE GJYKIMEVE (VAZHDIM)

5.2. Zhvleresimi

Matja e humbjes nga zhvleresimi si nen SNRF 9 per te gjitha kategorite e aktiveve financiare kerkon nje gjykim, veçanerisht ne vleresimin e shumes dhe kohes se flukseve te arketimeve te pritshme dhe vlerave te kolateraleve gjate percaktimit te humbjes se zhvleresimit dhe percaktimit te rritjes te qenesishme ne rrezikun e kredise. Keto vleresime drejtohen nga nje numer faktoresh, ndryshimet e te cilave mund te çojne ne nivele te ndryshme te fondeve te zhvleresimit.

Perlllogaritjet per ECL qe ben Banka jane rezultat i modeleve komplekse me nje sere supozimesh qe kane te bejne me zgjedhjen e inpueteve te ndryshme dhe varesine e tyre nga njeri tjetri.

Elementet e modeleve per ECL qe konsiderohen nje gjykim dhe vleresim kontabel perfshijne:

- Kriteret e Bankes per te vleresuar nese ka patur nje rritje te konsiderueshme ne rrezikun e kredise dhe nese fond i zhvleresimit do duhet te matet si LTELK dhe vleresimet cilesore,
- Segmentimi i aktiveve financiare kur ECL e tyre vleresohet ne baza kolektive,
- Zhvillimi i modeleve per ECL, duke perfshire formula te ndryshme dhe zgjedhjen e inpueteve,
- Percaktimin e lidhjes midis skenareve makroekonomik dhe inpueteve ekonomike si nivelet e PBB dhe vlerave te kolateraleve, dhe efektin ne PD-te, EAD-te dhe LGD-te,
- Perzgjedhjen e skenareve makroekonomike qe pritet te ndodhin per te percaktuar inputet ekonomike ne modelet e ECL-se.

Nje vleresim per te pare nese nje investim ne borxhin qeveritar eshte zhvleresuar mund te jete i nderlikuar. Ne berjen e nje vleresimi te tille, Banka e konsideron vleresimin e tregut te kreditimit, siç pasqyrohet ne yield-in e obligacioneve, vleresimet e agjencive te klasifikimit te kreditimit, aftesia e vendit per te hyre ne tregjet e kapitalit per leshimin e borxhit te ri, probabiliteti i ristrukturimit te borxhit duke rezultuar ne humbje te mbajtesit nepermjet faljes vullnetare apo te detyrueshme se borxhit dhe mekanizmat nderkombetare te mbeshtetjes per te siguruar mbeshtetjen e nevojshme si “huadhenes i fundit” ne ate vend po ashtu si dhe synimin, pasqyruar ne deklaratat publike, ne lidhje me gatishmerine e qeverive dhe agjencive per te perdorur keto mekanizma. Kjo perfshin nje vleresim si per thellesine e ketyre mekanizmave dhe, pavaresisht qellimit politik, nese ka kapacitet per te permbushur kriteret e kerkuara.

5.3. Vlera e drejte

5.3.1. Vlera e drejte e instrumenteve financiare

‘Vlera e drejte’ e nje instrumenti financiar eshte çmimi me te cilin aktivi mund te shitet, ose nje detyrim te transferohet, ne nje transakcion te zakonshem mes pjesemarresve ne nje treg primar ne daten e matjes, nen kushtet aktuale te tregut, pavaresisht faktit nese çmimi eshte drejt per drejt i kuotuar apo vleresohet nepermjet teknikave te matjes. Kur vlera e drejte e nje aktivi financiar te regjistruar ne pasqyren e pozicionit financiar nuk mund te derivohet nga tregjet aktive, ajo percaktohet duke perdorur teknika te ndryshme vleresimi qe perfshijne perdorimin e modeleve te vleresimit te pershkruara ne Shenimin 37. Inputet ne keto modele, aty ku munden, merren nga tregjet aktive, por ne rastet kur keto nuk jane te mundshme, percaktimi i vleres se drejte behet nepermjet vleresimit. Per instrumentet financiare qe tregtohen rralle dhe kane transparence te pakte te çmimeve, vlera e drejte eshte me pak objektive, dhe kerkon shkalle te ndryshme te gjykimit ne varesi te likuiditetit, perqendrimit, pasigurise se faktoreve te tregut, supozime rreth çmimit dhe risqe te tjera qe ndikojne mbi instrumentin specifik.

5.3.2. Vlera e drejte e aktiveve jofinanciare

Vlera e drejte e investimeve ne pasuri te paluajtshme dhe Vlera neto e realizueshme e kolateraleve te sekuestruara percaktohet nga vleresues pasurie te jashtem ose te brendshem, te cilet kane kualifikime te duhura te njohura profesionale dhe njohurite e nevojshme te vendndodhjes dhe kategorise te prones qe vleresohet. Matja e vleres se drejte per te gjitha pronat ne keto kategori, bazuar ne teknikat e vleresimit te perdorura (Shenimi 4.18), klasifikohen si Niveli 3 i vleres se drejte. Pervec vleresimeve te pasurive disa vleresime behen per te percaktuar mundesine e shitjes se aktiveve nen kategorine e aseteteve.

5.4. Vijueshmeria

Menaxhimi i pergatiti keto pasqyra financiare te vecanta ne baze te parimit te vijushmerise. Ne arritjen e ketij gjykimi, menaxhimi konsideroi pozicionin financiar te Bankes, qellimet aktuale, perfitueshmerine e operacioneve dhe aksesin ne burimet financiare, si dhe analizoi ndikimin e krizes me te fundit financiare ne veprimtarine e ardhshme te Bankes.

5. PERDORIMI I VLERESIMEVE DHE GJYKIMEVE (VAZHDIM)

5.5. Percaktimi i afatit te qirase per kontratat me opsionin e rinovimit dhe te perfundimit para afatit (Banka si qiramarrrese)

Banka percakton afatin e qirase si periudha e paanullueshme e qirase se bashku me periudhat e mbuluara nga nje opsion per te zgjatur qirane nese ka siguri te arsyeshme per ta ushtruar ate, ose periudhave te mbuluara nga nje opsion per te perfunduar qirane nese ka sigurine e arsyeshme per te mos e ushtruar ate. Banka ka disa kontrata qe kane opsionet per te zgjatur apo perfunduar afatin e qirase. Banka ben gjykime gjate vleresimit nese eshte e sigurte ne menyre te arsyeshme nese do te ushtroje apo jo opsionet per te zgjatur apo perfunduar qirate. Kjo do te thote qe konsideron te gjitha faktoret e rendesishem qe krijojne nje nxitje ekonomike per Banken per ushtruar ose rinovimin ose perfundimin. Pas dates se fillimin, Banka rivlereson afatet e qirave nese ka patur ndonje ngjarje te rendesishme ose ndryshim ne rrethana qe jane ne kontrollin e saj qe ndikojne mundesine e saj per te ushtruar ose jo opsionin e rinovimit apo perfundimit (psh. Permiresime te rendesishme te ambienteve ose pershtatje te rendesishme ne aktivitet me marre me qira).

5.6. Percaktimi i normes rritese te huamarrjes

Banka nuk mund te percaktojte normen e interesit te nenkuptuar te qirase, per kete, ajo perdor normen rritese te huamarrjes ('IBR') per te matur detyrimet per qirate. IBR eshte norma e interesit qe Banka do kishte paguar per te marre hua ne afate te ngjashme fondet e nevojshme per te perfituar nje aktiv ne vlere te njejte me vleren e aktivitet me te drejte perdorimi ne nje ambient te ngjashem ekonomik. Per kete IBR reflekton ate çfare Banka 'do duhej te paguaje', e cila kerkon nje vleresim kur mungojne normat e vëzhgueshme ne treg ose kur ato do duhet te rregullohen per te reflektuar kushtet e qirase (psh, kur qiraja eshte ne monedhe te ndryshme nga ajo e normave te listuara). Banka vlereson IBR duke perdorur inputet e vëzhgueshme (si'c jane normat e inetersit ne treg) kur ato jane te mundshme dhe i duhet te beje disa rregullime specifike per to.

6. BLERJA E BANKES NDERKOMBETARE TREGTARE

Ne 1 nentor 2018, Banka nenshkroi nje marreveshje shitblerjeje me aksionaret e Banka Nderkombetare Tregtare sha ('BNT') per blerjen 100% te aksioneve te BNT, nje banke shqiptare, e regjistruar si shoqeri aksionare ne 1996 dhe e licencuar ne 20 shkurt 1997. Blerja u finalizua ne 20 mars 2019 ("Data e Blerjes"), pas marrjes se miratimit paraprak nga Banka e Shqiperise ne date 18 mars 2019. Regjistrimi i ketyre aksioneve ne Qendren Kombetare te Biznesit u be ne 27 mars 2019.

Pas marrjes se miratimit nga Banka e Shqiperise ne date 3 korrik 2019 per bashkimin me perthithje me BNT, ne 1 gusht 2019 ('Data e Bashkimit') u be bashkimi legal dhe operacional i te dy bankave.

Blerja u regjistrua duke perdorur metoden e blerjes. Nga Data e Blerjes deri ne Daten e Bashkimit ish-BNT operoi si filial i Bankes.

Aktivitet dhe detyrimet e BNT u bashkuan me ato te Bankes bazuar ne koston e amortizuar te vleres se drejte te tyre te percaktuar siaps metodes se blerjes, kur ato ndryshonin shume me vleren e tyre kontabel. Diferenca midis aktiveve dhe detyrimeve neto te transferuara nga bashkimi dhe koston se blerjes se filialit u njoh ne kapital te Bankes si nje rezerve nga perthithja.